



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.94

2004

17 dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9309
datë 11.11.2004

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe të Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin e prodhimit të energjisë termike në Vlorë”..... 6527

Ligj nr.9311
datë 11.11.2004

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e menaxhimit të burimeve ujore”..... 6546

Tabela e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.786, datë 26.11.2004 “Për një ndryshim në vendimin nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”..... 6559

LIGJ
Nr.9309, datë 11.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH) DHE TË MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH), PËR PROJEKTIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË TERMIKE NË VLORË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe marrëveshja e kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për projektin e prodhimit të energjisë termike në Vlorë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4413, datë 13.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE GARANCIE

E DATËS 9 KORRIK 2004 NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“GARANTUESI”) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (“BANKA”)

HYRJE

Ndërsa Garantuesi dhe Korporata Elektroenergjetike shqiptare kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e projektit;

Ndërsa në pajtim me Marrëveshjen e huasë të kësaj date ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike shqiptare si Huamarrësi dhe Bankës (“Marrëveshja e huasë” siç është përcaktuar në kushtet dhe termat standarde), Banka ka rënë dakord t’i japë një hua Huamarrësit në shumën e dyzet milionë euro (EUR 40 000 000), sipas termave dhe kushteve të parashtruara ose referuara në Marrëveshjen e huasë, por vetëm me kusht që Garantuesi të garantojë detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së huasë, siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje;

Ndërsa Garantuesi, duke marrë në konsideratë që Banka po hyn në Marrëveshje kredie me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë detyrime të tilla të Huamarrësit, tani, dhe nëpërmjet kësaj, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Termet dhe kushtet standarde, përkufizime

Paragrafi 1.01 Zbatimi i termave dhe kushteve standarde

Të gjitha klauzolat e termave dhe kushteve standarde të Bankës të shkurtit 1999 janë përfshirë këtu dhe janë bërë të aplikueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën forcë dhe efekt sikur të ishin plotësisht të parashtruara në këtë Marrëveshje.

Paragrafi 1.02 Përkufizime

Të përdorura kudo në këtë Marrëveshje (përfshirë hyrjen), nëse nuk bëhet e ditur ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në hyrje kanë kuptimet respektive dhënë atyre nga kjo pikëpamje, termat e përcaktuar në kushtet dhe termat standardë dhe Marrëveshjen e Huasë kanë kuptimet respektive dhënë atyre nga kjo pikëpamje dhe termat që vijnë kanë kuptimet e mëposhtme:

“Programi i asistencës së bashkëmenaxhimit” ka kuptimin e një programi të asistencës së bashkëmenaxhimit të zhvilluar nga Huamarrësi në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën.

“Përfaqësuesi i autorizuar i Garantuesit” nënkupton Ministrinë e Financave të Garantuesit.

Paragrafi 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, referencat për nene ose paragrafë të veçantë do të interpretohen, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, si një referencë për atë nen ose paragraf të veçantë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Garancitë, detyrime të tjera

Paragrafi 2.01 Garantuesi garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si i detyruari themelor dhe jo thjesht si dorëzanë, pagesën e detyrueshme dhe të përpiktë të çdonjërës dhe të të gjitha shumave të detyrueshme sipas Marrëveshjes së huasë, me maturitetin e caktuar, me përshpejtim ose ndryshe, dhe përmbushjen e përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, të gjitha siç janë paraqitur në Marrëveshjen e huasë.

Paragrafi 2.02 Përfundimi i projektit

a) Nëse ka një shkak të justifikuar për të besuar që fondet e disponueshme për Huamarrësin do të jenë të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e vlerësuara të kërkuara për të realizuar projektin, Garantuesi do të marrë menjëherë masa të kënaqshme për Bankën që t'i sigurojë Huamarrësit ose të bëjë që Huamarrësi t'i sigurojë fondet e tilla që i nevojiten për t'i përballuar shpenzimet dhe kërkesat.

b) Pa kufizuar përgjithësimin e çdo klauzole tjetër në këtë Marrëveshje ose termat dhe kushtet standarde, Garantuesi do të autorizojë Huamarrësin të vërë në veprim, aq shpesh sa është e nevojshme, rregullimet në nivelin dhe strukturën e tarifave të Huamarrësit në mënyrë që të sigurohet që Huamarrësi të jetë i aftë të plotësojë detyrimet e tij sipas paragrafëve 3.01(c) dhe 3.01(d) të Marrëveshjes së huasë.

Paragrafi 2.03 Detyrime të tjera

Garantuesi:

a) do të heqë dorë nga vënia e taksave direkte ose indirekte konsulentëve të huaj të punësuar nga Banka ose Huamarrësi në zbatimin e projektit dhe të financuar nga të ardhurat e huasë ose të ndonjë fondi tjetër kooperues teknik të bërë disponibël nga Banka;

b) do të zbatojë deklaratën e politikës së sektorit energjetik;

c) do të mbështesë zbatimin e planit të veprimit nga Huamarrësi;

d) do të pushojë së ndërhyri në praktikat standarde të grumbullimit të Huamarrësit;

e) do t'i paguajë detyrimet e papaguara Huamarrësit për organizmat buxhetorë dhe ndërmarrjet shtetërore, ashtu siç është rënë dakord në planin e veprimit në mënyrë të tillë që ripagimi përfundimtar i bërë më 2005 do të sjellë balancën e detyrimeve në zero;

f) do të përfundojë gradualisht dhënien e subvencionit Huamarrësit, ashtu siç është rënë dakord në planin e veprimit, në mënyrë që pagesa finale e subvencionit të bëhet më 2004.

g) do të detyrojë të gjitha entet buxhetore dhe ndërmarrjet shtetërore që t'i paguajnë faturat e tyre Huamarrësit në afat ose në të kundërt të paguajë faturat e tyre në kohë, kështu që borxhet e reja për Huamarrësin nga këto ente, borxhe të tilla jo të identifikuar për amortizim në planin e veprimit, nuk do t'i kalojnë në çdo kohë 2 000 000 USD;

h) përveçse kur është rënë dakord ndryshe me Bankën, do të mbështesë zbatimin e Programit të Asistencës Bashkëmenaxhuese në një mënyrë të pranueshme për Bankën;

i) do t'i japë Huamarrësit të drejtën të parashikojë provigjionë për pagesat e pagrumbulluara të faturave të energjisë në përputhje me praktikat standarde të industrisë;

j) do të sigurojë ose do të detyrojë që të sigurohen, kur kërkohen, të gjitha licencat qeveritare, aprovimet ose miratimet e kërkuara nga Huamarrësi për financimin dhe realizimin e projektit dhe realizimin e biznesit të tij, përfshirë të gjitha aprovimet dhe licencat e nevojshme për t'u siguruar që Huamarrësit i janë dhënë të gjitha të drejtat dhe të drejtat e përdorimit të tokës të nevojshme për të realizuar projektin;

k) do të heqë dorë nga kërkesat drejtuar Huamarrësit për të bërë ndonjë investim të ri ose të hyjë në ndonjë koncesion të ri që nuk janë pjesë e planit të biznesit të Huamarrësit dhe, në veçanti, të heqë dorë nga kërkesat drejtuar Huamarrësit për të hyrë në koncensione të reja për HEC-et e vogla;

l) do të mbështesë çdo përpjekje nga Huamarrësi për të eliminuar tarifat subvencionuese të energjisë për konsumatorët buxhetorë dhe jobuxhetorë, si dhe konsumatorët privatë, nga 2005, me përjashtim të tarifave elektrike për kompanitë e ujësjellësve për të cilat tarifat e subvencionuara do të eliminohen nga 2007;

m) do të mbështesë krijimin nga Huamarrësi të një enti të tij, i cili do të zotërojë dhe operojë termocentralin e Vlorës;

n) do të mbështesë krijimin dhe vënien në funksionim nga Huamarrësi të një fondi balancimi;

o) do të marrë të gjitha masat e duhura për të marrë pjesë në tregun rajonal të energjisë së Europës Juglindore, siç përcaktohet nga Memorandumi i Mirëkuptimit për Tregun Rajonal të Energjisë në Europën Juglindore;

p) do të zhvillojë dhe do të zbatojë, përpara 31 dhjetorit 2004, procedurat për dhënien me koncesion të HEC-ve të vogla, me terma të pranueshme për Bankën.

Neni 3 Të ndryshme

Paragrafi 3.01 Njoftime

Adresat që vijojnë janë specifikuar për qëllimet e paragrafit 10.01 të kushteve dhe termave standarde:

Për Garantuesin:

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrisë të Financave

Fax +355 4 228494

Për Bankën

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square, London EC2A 2JN, UK

Në vëmendje të: Operation Administration Unit

Fax +44-0-7338-6100

Telex 8812161

Answerback: EBRD L G

Paragrafi 3.02 Opinionet ligjore

Për qëllimet e paragrafit 9.03(b) të kushteve dhe termave standarde dhe në pajtim me paragrafin 6.02 të Marrëveshjes së huasë, opinionit ose opinionet do të jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Në cilësinë e dëshmitarit, palët në këtë Marrëveshje, që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar siç duhet, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje në Tiranë, Republika e Shqipërisë në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga: -----
Emri: z. Arben Malaj
Titulli: Ministër i Financave

BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM
Nga: -----
Emri: z. Tony Marsh
Titulli: Drejtor

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE DHE BANKËS
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
(PROJEKTI I GJENERIMIT TË ENERGJISË TERMIKE VLORE)

Marrëveshje e datës 9 korrik 2004 ndërmjet KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (“Huamarrësi”) dhe BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (“Banka”).

HYRJE

Ndërkohë që Banka ka qenë e vendosur të sigurojë financime për projekte të veçanta për të përkrahur transicionin drejt ekonomive të hapura ndaj tregut të orientuar dhe për të nxitur iniciativat private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore të angazhuara dhe në zbatim të parimeve të demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomive të tregut;

Ndërkohë që Huamarrësi synon të zbatojë projektin siç është përshkruar në shtojcën 1, i cili është projektuar për të asistuar Huamarrësin në financimin e ndërtimit të një termocentrali të ri me cikël të kombinuar, me naftë, në Vlorë, Republika e Shqipërisë;

Ndërkohe që Huamarrësi synon të akordojë një shumë prej afërsisht dhjetë milionë e dyqind mijë euro (10 200 000) për financimin e projektit;

Ndërkohë që, Republika e Shqipërisë dhe Huamarrësi kanë kërkuar asistencë nga Banka për financimin e projektit;

Ndërkohë që Huamarrësi është në procesin e sigurimit të një huaje nga Banka Europiane e Investimeve (BEI) dhe Republika e Shqipërisë ka kontraktuar një kredi (e cila do t’i nënshtruhet Huamarrësit) nga Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit (“IDA” me së bashku me BEI, “Bashkëfinancuesit”), në sasi të (ekuivalente me) 40 milion euro dhe 25 milionë USD, respektivisht, për të asistuar në financimin e projektit, nënshtruar termave dhe kushteve të parashtruara në një ose më shumë marrëveshje (Marrëveshjet e “Bashkëfinancimit”) ndërmjet Huamarrësit dhe Republikës së Shqipërisë dhe secilit nga bashkëfinancuesit;

Ndërkohë që në pajtim me një marrëveshje garancie e datuar sipas datës së kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Republikës së Shqipërisë si garantues (“Garantuesi”) dhe Bankës (“Marrëveshja e Garancisë”) siç është përcaktuar në kushtet dhe termat standarde, Garantuesi ka garantuar detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

Ndërkohë që Banka ka rënë dakord, midis të tjerave, mbi bazat e përsa më sipër t’i japë një hua Huamarrësit në shumën e dyzet milionë euro (40 000 000) nënshtruar termave dhe kushteve paraqitur ose referuar në këtë Marrëveshje,

tani dhe nëpërmjet kësaj, palët bien dakord për sa më poshtë:

Kushtet dhe termat standarde, përkufizimet

Paragrafi 1.01 Përfshirja e kushteve dhe termave standarde

Të gjitha klauzolat e kushteve dhe termave standarde të Bankës të shkurtit 1999 janë të përfshira këtu dhe janë bërë të aplikueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën forcë dhe efekt sikur të ishin parashtruar plotësisht në këtë Marrëveshje, nënshtruar, megjithatë, modifikimeve që vijnë (këto klauzola të modifikuara në këtë mënyrë do të quhen më pas “Kushtet dhe termat standarde”):

a) Përkufizimi i “Ditës së punës” në paragrafin 2.02 të kushteve dhe termave standarde të Bankës së shkurtit 1999 do të modifikohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe lexohet si vijon:

“Ditë-pune” do të thotë dita në të cilën është hapur Sistemi Trans-European Automated Real-Time Gross Settlement Express Transfer (TARGET).

b) Përkufizimi i “Unwinding Cost” në paragrafin 2.02 të kushteve dhe termave standarde të Bankës të shkurtit 1999 për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje do të modifikohet dhe lexohet si vijon:

“Unwinding Costs” do të thotë shuma me anë të së cilës shuma origjinale e të ardhurave (Original income stream) e tejkalon shumën alternative të të ardhurave (Substitute Income Stream), ku:

a) “Shuma origjinale e të ardhurave” do të thotë shuma agregate e vlerave aktuale të pagesave të principalit dhe interesit, të cilat i bëhen të atribueshme Bankës gjatë periudhës së kalkulimit (siç është përcaktuar më poshtë) mbi pjesën e huasë, e cila i nënshtrohet një norme fikse të interesit, nëse kjo parapagesë, përshpejtim ose anulim nuk është bërë dhe nëse për këtë pjesë të huasë është grumbulluar interes me normën e interesit përkatës të tregut;

b) “Shuma alternative e të ardhurave” do të thotë:

1. Shuma agregate e vlerave aktuale të çdo pagese të mbetur të principalit dhe interesit e cila pas marrjes parasysh të parapagesës, anulimit ose përshpejtimit do t’i atribuohet Bankës gjatë periudhës së kalkulimit për pjesën e huasë, e cila i nënshtrohet një norme fikse interesi nëse për këtë pjesë të huasë është akumuluar interes me normën e interesit të tregut përkatës; dhe

2. siç është e zbatueshme:

A) në rastin e një parapagese në pajtim me paragrafin 3.07 të kushteve dhe termave standarde, vlera aktuale e sasisë së huasë që do të parapaguhet, e përcaktuar duke zbritur këtë shumë nga data që kjo pagesë realizohet deri në datën e kalkulimit (siç është përcaktuar më poshtë) me përqindjen e skontimit (siç është përcaktuar më poshtë); dhe/ose

B) në rastin e çdo parapagese tjetër, sasia e huasë e cila është parapaguar ; dhe/ose

C) në rastin e një përshpejtimi, vlera aktuale e shumës së Huasë e cila është përshpejtuar, e përcaktuar me zbritjen e kësaj shume që nga data që ky përshpejtim bëhet efektiv deri në datën e kalkulimit me përqindjen e skontimit; dhe/ose

D) në rastin e një anulimi, vlera aktuale e shumës së huasë e cila është anuluar, e përcaktuar me zbritjen e kësaj shume nga data e fundit e disponibilitetit deri në datën e kalkulimit, me përqindjen e skontimit.

c) Për qëllimet e paragrafëve (a) dhe (b)(1) më sipër, vlera aktuale e çdo pagese të principalit dhe interesit do të përcaktohet duke zbritur sasinë e këtyre pagesave nga data kur duhet bërë pagesa deri në datën e kalkulimit, duke përdorur përqindjen e skontimit.

d) “Dita e kalkulimit” ka kuptimin e:

1. në rastin e një parapagese në pajtim me paragrafin 3.07 të kushteve dhe termave standarde datës së dy ditëve-pune para datës së kryerjes së kësaj parapagese ose, sipas opsionit të Bankës, data në të cilën kjo parapagesë do të kryhet;

2. në rastin e ndonjë parapagimi tjetër, datës në të cilën ky parapagim është kryer ose një datë tjetër të mëvonshme siç mund ta zgjedhë Banka me dëshirën e saj;

3. në rastin e një përshpejtimi ose anulimi, ditës së dy ditëve pune para datës së bërjes së vlefshme të anulimit ose përshpejtimit ose, sipas opsionit të Bankës, data në të cilën ky përshpejtim ose anulim bëhet i vlefshëm.

e) “Periudha e kalkulimit” do të thotë:

1) në rastin e një parapagese në pajtim me paragrafin 3.07 të kushteve dhe termave standarde, periudha që fillon nga data në të cilën kjo parapagesë bëhet e pagueshme dhe që mbaron në datën e fundit të pagesës së huasë;

2. në rastin e çdo parapagese tjetër, periudha që fillon nga data në të cilën është bërë kjo parapagesë, ose një datë tjetër e mëvonshme siç mund ta zgjedhë Banka me dëshirën e saj dhe që mbaron në datën e fundit të pagesës së huasë;

3. në rast të një përshpejtimi ose anulimi, periudha që fillon nga data në të cilën ky anulim ose përshpejtim bëhet i vlefshëm dhe që mbaron datën e fundit të pagesës së huasë.

f) “Përqindja e skontimit” do të thotë faktori i skontimit për maturitetin përkatës që rrjedh nga kurba e këmbimit për monedhën e huasë e cila është e disponueshme për Bankën në tregun e këmbimit të normës së interesit dhe të opsioneve në “Datën e kalkulimit”.

c) Paragrafi 3.10 i kushteve dhe termave standarde të Bankës i datës shkurt 1999 do të modifikohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe lexohet si vijon:

“Paragrafi 3.10 Unwinding Costs”

a) Nëse, për çdo arsye (përfshirë, pa kufizim, një përshpejtim në pajtim me paragrafin 7.06 të kushteve dhe termave standarde), çdo pjesë e huasë, e cila i nënshtrohet një norme interesi të ndryshueshme bëhet e atribueshme dhe e pagueshme në një datë tjetër, përveç ditës së fundit të një periudhe interesi, Huamarrësi do t’i paguajë Bankës me kërkesë shumën, nëse ka, me të cilën:

1. interesi i akumuluar mbi këtë pjesë të huasë që nga data në të cilën kjo pjesë e huasë është bërë e atribueshme dhe e pagueshme deri në ditën e fundit të periudhës së interesit të asaj kohe me një normë të barabartë me normën e interesit të tregut përkatës për këtë pjesë të huasë për këtë periudhë interesi;

e tejkalon:

2. interesin të cilin Banka do të mund të fitonte nëse ajo do të vinte një shumë të barabartë me këtë pjesë të huasë në depozitë me një bankë kryesuese në tregun ndërbankar të eurozonës për periudhën që fillon nga data në të cilën kjo pjesë e huasë është bërë e atribueshme dhe e pagueshme dhe që mbaron në ditën e fundit të kësaj periudhe interesi.

b) Nëse, në çdo kohë:

1. Huamarrësi në pajtim me paragrafin 3.07 të kushteve dhe termave standarde, njofton për parapagese të çdo pjese të huasë, e cila i nënshtrohet një norme interesi fikse ose Huamarrësi parapaguan ndryshe çdo pjesë të huasë;

2. Çdo pjesë e huasë, e cila i nënshtrohet një normë interesi fikse përshpejtohet në pajtim me paragrafin 7.06 të kushteve dhe termave standarde ose ndryshe bëhet e atribueshme para maturitetit të caktuar;

3. Çdo pjesë e Huasë, e cila i nënshtrohet një normë interesi fikse anulohet në pajtim me paragrafin 3.08, 7.02 ose 7.06 të kushteve dhe termave standarde ose anulohet ndryshe;

Huamarrësi, përveç çdo komisioni administrativ parapagese, komisioni anulimi ose shumash të tjera të pagueshme në lidhje me këto, do t’i paguajë Bankës me kërkesën e kësaj, shumën e çdo Unwinding Costs, me kusht që, nëse shuma e Unwinding Costs është negative, Banka do t’i kreditojë Huamarrësit, në datën tjetër të pagimit të interesit, në monedhën e huasë, shumën e Unwinding Costs.

c) Nëse ndonjë shumë e papaguar paguhet në një datë, përveç ditës së fundit të periudhës së llogaritjes së interesvonesave, Huamarrësi do t’i paguajë Bankë, me kërkesën e kësaj të fundit, shumën, nëse ka, në të cilën:

1. Interesi, i cili do të ketë rrjedhur mbi këtë shumë të papaguar nga data e marrjes së kësaj shume deri në ditën e fundit të periudhës së llogaritjes së interesvonesave me një normë të barabartë me normën e përcaktuar në paragrafin 3.09(a)(iii) të kushteve dhe termave standarde për këtë periudhë të llogaritjes së interesvonesave;

e tejkalon

2. Interesin të cilin Banka do të mund të fitonte nëse ajo do të vinte një shumë të barabartë me këtë shumë të papaguar në depozitë me një bankë kryesuese në tregun ndërbankar të eurozonës për periudhën që fillon nga data e marrjes së kësaj shume të papaguar dhe që mbaron në ditën e

fundit të periudhës së llogaritjes së interesvonesave;

d) Një dëshmi e Bankës për çdo shumë të paguar në pajtim me paragrafin 3.10 do të jetë e pandryshueshme, përfundimtare dhe e detyrueshme mbi Huamarrësin, përveçse kur manifestohet nga Huamarrësi me pëlqimin e Bankës për përmbajtjen e gabimeve të dukshme.

Paragrafi 1.02 Përkufizime

Të përdorura kudo në këtë Marrëveshje (përfshirë parathënien dhe shtojcat), nëse nuk bëhet e ditur ndryshe ose konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në hyrje kanë kuptimet respektive dhënë atyre këtu, termat e përcaktuar në kushtet dhe termat standarde kanë kuptimet respektive dhënë atyre nga kjo pikëpamje dhe termat që vijnë kanë kuptimet e mëposhtme:

“Plan veprimi” nënkupton planin e veprimit për vitet 2004-2006 adoptuar nga Huamd 2004 “Mbi aprovimin e planit të veprimeve për sektorin elektroenergjetik për vitet 2004-2006”, plan i cili mund të ndryshohet nga koha në kohë në marrëveshje me Bankën për të mbuluar vitet që vijnë.

“Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Huamarrësit.

“Fluksi i parave i disponueshëm” nënkupton fluksin e parave nga aktivitetet për shërbimet e borxhit operuese plus çdo interes të paguar gjatë periudhës.

“Fluksi i parave nga aktivitetet operuese” nënkupton gjithë fluksin e parave nga aktivitetet operuese siç është përcaktuar sipas GAAP. Nëse, për çdo arsye, asnjë deklaratë financiare GAAP e audituar nuk është e disponueshme për çdo vit fiskal, fluks parash nga aktivitetet operuese nënkupton, për çdo periudhë të tillë, fitimet neto të Huamarrësit gjatë një periudhe të tillë pas tatimit, plus zhvlerësimin dhe amortizimin, plus të gjitha shpenzimet që nuk bëhen me para në dorë, plus çdo zhvlefësim gjatë një periudhe të tillë (ose, sipas rastit, minus çdo vlerësim gjatë një periudhe të tillë) në kapitalin punëve.

“Bashkëmenaxhues” nënkupton çdo entitet i angazhuar sipas programit të asistencës së bashkëmenaxhimit dhe i pranueshëm për Bankën.

“Programi i asistencës së bashkëmenaxhimit” nënkupton programin e asistencës së bashkëmenaxhimit të cilit i referohet në paragrafin 3.06.

“Borxh” nënkupton, lidhur me Huamarrësin mbi bazë të konsoliduar, të gjitha detyrimet e Huamarrësit në formën e principalit apo garanci, të tashme, të ardhme, aktuale ose të parashikuara, për pagesën ose ripagesën e parave, përfshirë, pa kufizime:

a) çdo shumë të pagueshme nga Huamarrësi për qiradhënie apo marrëveshjeve të ngjashme në periudhat e tyre respektive;

b) çdo kredi dhënë Huamarrësit nga një furnizues mallrash ose sipas çdo blerje me këste ose çdo dispozitë tjetër të ngjashme;

c) çdo borxh dhe detyrim të palëve të treta në atë masë që ato janë garantuar nga Huamarrësi ose Huamarrësi në të kundërt e ka marrë përsipër ose është bërë përgjegjës për pagesën e borxheve të tilla ose detyrimeve ose në atë masë që ato janë siguruar nga çdo e drejtë mbi pronën e zotëruar nga Huamarrësi, nëse Huamarrësi ka marrë ose jo përsipër ose është bërë përgjegjës për pagesën e këtyre borxheve ose detyrimeve.

“Shërbimi i borxhit” nënkupton, për çdo periudhë, shumën e të gjitha pagesave të planifikuara të principalit, interesit dhe komisioneve mbi të gjithë borxhin e Huamarrësit.

“Llogaria e shërbimit të borxhit” nënkupton llogarinë e depozitës që mbart interes referuar në paragrafin 3.08 (a).

“Koeficienti i mbulimit të shërbimit të borxhit” nënkupton koeficientin e fituar nga pjesëtimi i fluksit të parave të disponueshme për shërbimin e borxhit me shërbimin e borxhit.

“Shuma rezervë e shërbimit të borxhit” nënkupton, në çdo kohë dhe sipas monedhës së huasë, shumën të principalit, interesit dhe shumave të tjera të planifikuara për t’i paguar Bankës në gjashtë muajt që vijnë shumëzuar me 1.25.

“Plani i veprimit të mjedisit” nënkupton planin e veprimit të mjedisit të pranueshëm për Bankën në formë dhe përmbajtje që do të përgatitet nga Huamarrësi dhe do t’i jepet Bankës, si i tillë plani i veprimit të mjedisit mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

“Fondi balancues” nënkupton një fond balancues që do të krijohet nga Huamarrësi në formë dhe përmbajtje i pranueshëm për Bankën me qëllim që të sigurojë që fitimet e rezultuara nga kushtet e favorshme hidrologjike janë vendosur mënjanë për të mbuluar kostot shtesë për importet e energjisë elektrike, të shkaktuara nga kushtet jo të favorshme hidrologjike.

“Vit fiskal” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon nga 1 janari i çdo viti.

“Parimet e kontabilitetit të pranuar në tërësi” nënkupton standardet financiare ndërkombëtare të raportimit të nxjerra ose të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) dhe që zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.

“Data e konvertimit të interesit” do të thotë një datë e pagimit të interesit e zgjedhur nga Huamarrësi në përputhje me paragrafin 2.02(h)(2)(B).

“Data e fiksimit të interesit” ka kuptimin e një dite pune të zgjedhur nga Huamarrësi në përputhje me paragrafin 2.02(h)(2)(B).

“Investment plan” nënkupton një plan investimi të përgatitur nga Huamarrësi në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën.

“Leku” ka kuptimin e monedhës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

“Llogaria lokale e projektit” nënkupton llogarinë depozituese që mbart interes referuar në paragrafin 3.08.(b).

“Shuma rezervë lokale e projektit” nënkupton, në çdo kohë gjatë periudhës së ndërtimit, shumën nga kontributet e Huamarrësit për projektin në gjashtë muajt që vijnë.

“Memorandumi i mirëkuptimit për tregun energjetik rajonal në Europën Juglindore” nënkupton memorandumën e mirëkuptimit të datës 8 dhjetor 2003, nënshkruar nga Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rumania, Turqia, Serbia, Mali i Zi, Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Bashkimi Europian që siguron angazhimin dhe futjen në një proces të vendeve nënshkruese, për të përmirësuar sektorin energjetik të rajonit të Europës Juglindore dhe për të krijuar një treg për energjinë elektrike dhe gazin në rajonin e Europës Juglindore, i cili si i tillë mund të ndryshohet kohë pas kohe.

“Raport veprimi” do të thotë një raport veprimi që do t’i jepet nga Huamarrësi Bankës, i pranueshëm për Bankën në formë dhe përmbajtje.

“PMU” nënkupton njësinë e zbatimit të projektit referuar në paragrafin 3.02.

“Dokumenti politik i sektorit energjetik” nënkupton dokumentin politik të adoptuar nga Këshilli i Ministrave të Garantuesit në 19 prill 2002, i cili mund të amendohet herë pas here me marrëveshje me Bankën.

“Fletë referencë” nënkupton paraqitjen e interesave të ofruara në tregun ndërbankar të eurozonës për depozitat në monedhën e Huasë të përcaktuara si faqja 248 në Moneyline Telerate (ose faqe tjetër që mund të zëvendësojë faqen 248 në Moneylinë Telerate për qëllimin e paraqitjes së interesave të ofruara në tregun ndërbankar të eurozonës për depozitat në monedhën e Huasë).

“Statutet” nënkupton dokumentet e themelimit dhe organizimit të Huamarrësit.

“Degë” nënkupton, në lidhje me një njësi, të çdo njësie tjetër ku mbi 50% e kapitalit të së cilës zotërohet, direkt ose indirekt, nga kjo njësi ose i cili efektivisht kontrollohet nga kjo njësi.

“Dollar“, “USD“ ose “\$“ nënkupton monedhën ligjore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Paragrafi 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë për një nen të veçantë, paragraf ose aneks do të interpretohet, përveç kur bëhet e ditur ndryshe në këtë Marrëveshje, si një referencë për atë nen të veçantë, paragraf të, ose aneks në, këtë Marrëveshje.

Neni 2
Termat kryesore të Huasë

Paragrafi 2.01 Sasia dhe monedha

Banka bie dakord t'i huajë Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të paraqitura ose të referuara në këtë Marrëveshje, shumën e dyzet milionë euro (40 000 000).

Paragrafi 2.02 Terma të tjerë financiare të Huasë

- a) Sasia minimale e shumës së tërhequr do të jetë 200 000 euro
- b) Sasia minimale e parapagesës do të jetë 5 000 000 euro
- c) Sasia minimale e anulimit do të jetë 3 000 000 euro
- d) Datat e pagesës së interesit do të jenë 5 prill dhe 5 tetor të çdo viti.
- e) Huamarrësi do të paguajë principalin e Huasë në datat dhe shumat e mëposhtme

Datat e rikthimit të Huasë	Sasia e principalit
5 prill 2008	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2008	EUR 1,739,130,00
5 prill 2009	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2009	EUR 1,739,130,00
5 prill 2010	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2010	EUR 1,739,130,00
5 prill 2011	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2011	EUR 1,739,130,00
5 prill 2012	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2012	EUR 1,739,130,00
5 prill 2013	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2013	EUR 1,739,130,00
5 prill 2014	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2014	EUR 1,739,130,00
5 prill 2015	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2015	EUR 1,739,130,00
5 prill 2016	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2016	EUR 1,739,130,00
5 prill 2017	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2017	EUR 1,739,130,00
5 prill 2018	EUR 1,739,130,00
5 tetor 2018	EUR 1,739,130,00
5 prill 2019	EUR 1,739,140,00
Totali	EUR 40,000,000.00

- f) Data e fundit e vlefshmërisë do të jetë 31 mars 2008.
- g) Norma e komisionit të angazhimit do të jetë 0.5 % për vit.
- h) Norma e interesit.

1. Huaja është subjekt i një norme të ndryshueshme të interesit. Për qëllimet e paragrafit 3.04(b) të kushteve dhe termave standarde, norma përkatëse e interesit të tregut do të jetë norma vjetore e ofruar për depozitat në monedhën e Huasë që shfaqet në faqen e referencës deri në 11:00 a.m, ora e Brukselit, në datën përkatëse të përcaktimit të interesit për periudhën që është më afër me kohëzgjatjen e periudhës së interesit që lidhet me të (ose nëse dy periudhat janë të barabarta, nga pikëpamja e kohëzgjatjes së periudhës përkatëse të interesit, merret norma mesatare e të dyjave); duke siguruar që:

A) Nëse, për çfarëdo arsye, norma përkatëse e interesit të tregut nuk mund të përcaktohet në një kohë të tillë duke iu referuar faqes së referencës, norma përkatëse e interesit të tregut do të jetë norma të cilën Banka e përcakton si të mesmen aritmetike (e rrumbullakosur në rritje, nëse është e nevojshme, te më e afërta 1/16%) të normave vjetore të ofruara për depozitat në monedhën e

huasë në një shumë të krahasueshme me pjesën e huasë që i nënshtrohet një norme të ndryshueshme interesi, të programuar për të qenë e papaguar gjatë periudhës së interesit përkatës, për një periudhë të barabartë me këtë periudhë interesi, norma të cilat i këshillohen Bankës nga tri banka kryesore aktive në tregun ndërbankar të eurozonës të zgjedhura nga Banka.

B) Nëse Banka përcakton që depozitat në monedhën e huasë, nuk janë të ofruara në tregun ndërbankar të eurozonës, për këto shuma apo këtë periudhë, norma e interesit të tregut do të jetë kosto për Bankën (e shprehur si normë vjetore) për të siguruar atë pjesë të huasë së planifikuar, që i nënshtrohet normës së ndryshueshme të interesit dhe që mbetet e padisbursuar në periudhën e interesit nga çfarëdo burimi të zgjedhur nga Banka.

2) Pavarësisht nga sa më sipër, Huamarrësi mund të zgjedhë si alternativë që mbi të gjitha ose pjesë të Huasë deri atëherë të papaguar, në vend të interesit mbi bazën e normës e ndryshueshme të interesit, të paguajë interesin mbi një normë interesi fikse mbi këtë pjesë të Huasë, si vijon:

A) Huamarrësi mund të ushtrojë opsione të tilla vetëm nëse:

i) në kohën e ushtrimit asnjë ngjarje e përcaktuar në paragrafin 7.01 të kushteve dhe termave standarde (ose asnjë ngjarje që me njoftim dhe/ose me interval kohe mund të quhet ngjarje) nuk ka ndodhur ose po vazhdon; dhe

ii) shuma e principalit të Huasë, e cila është konvertuar nga një normë interesi e ndryshueshme në një normë interesi fikse nuk është më pak se (10 000 000 euro).

B) Huamarrësi do të ushtrojë një opsion të tillë duke njoftuar Bankën jo më pak se pesë ditë - pune para datës së propozuar të fiksimit të interesit. Ky njoftim do të jetë, nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, i parevokueshëm dhe do të përcaktojë datën e fiksimit të interesit dhe datën e konvertimit të interesit të zgjedhur nga Huamarrësi dhe shumën principale të Huasë që do të konvertohet me një normë interesi fikse.

C) Duke filluar nga data e konvertimit të interesit, pjesa e Huasë që do të konvertohet (siç është përcaktuar në njoftimin e Huamarrësit) do t'i nënshtrohet një norme interesi fikse. Për qëllimet e paragrafit 3.04 (a) të kushteve dhe termave standarde, norma përkatëse e interesit të tregut do të jetë norma fikse e interesit të mëparshëm për monedhën e Huasë, e cila, është e disponueshme për Bankë, në tregun e këmbimit të normës së interesit në këtë datë të fiksimit të interesit për periudhën që fillon në këtë datë të konvertimit të interesit dhe që mbaron në datën e ripagesës përfundimtare të Huasë, duke pasur parasysh ripagesën e principalit dhe afatet e pagesës së interesit për Huanë. Banka do të përcaktojë normën fikse të Interesit në datën e fiksimit të interesit dhe menjëherë t'i japë njoftim Huamarrësit dhe Garantuesit.

D) Banka në çdo kohë t'i zgjedhë që të konsolidojë të gjitha normat fikse të interesit të aplikueshme deri atëherë për pjesë të Huasë në një normë fikse interesi të vetme të barabartë me mesataren e vlerësuar të normave fikse të interesit deri atëherë të aplikueshme për pjesë të Huasë. Banka do të përcaktojë normën fikse të interesit të konsoliduar dhe menjëherë t'i japë njoftim Huamarrësit. Kjo Normë Fikse e Interesit të konsoliduar do të jetë e aplikueshme për të gjitha pjesët e Huasë që deri atëherë bartnin interesat në norma interesi fikse duke filluar nga data e pagimit të Interesit që vjen menjëherë mbas njoftimit që i bëhet Huamarrësit nga Banka.

Paragrafi 2.03 Tërheqjet e shumave të huasë

a) Shuma e disponueshme mund të tërhiqet herë pas here në përputhje me klauzolat e shtojcës 2 për të financuar (1) shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka bie dakord të bëhet kështu) sipas kostos së arsyeshme të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe (2) Komisionin Front-end.

b) Huamarrësi këtu autorizon Bankën të tërheqë nga shuma e disponueshme një shumë të barabartë me Komisionin Front-end dhe t'i paguajë vetes Komisionin Front-end në emër të Huamarrësit.

Neni 3 Ekzekutimi i projektit

Paragrafi 3.01. Marrëveshje të tjera mbështetese të projektit

Lidhur me sipërmarjet e përgjithshme të shtjelluara në nenin IV të kushteve dhe termave standarde, Huamarrësi përveçse kur Banka bie dakord ndryshe:

a) do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar fonde të mjaftueshme për përfundimin e projektit;

b) do të adoptojë dhe zbatojë planin e veprimit që mbulon të gjitha aspektet e veprimtarive të tij për periudhën dyvjeçare që vijon para 30 nëntorit të secilit vit;

c) do të sigurojë arritjen në kohë të objektivave financiare të specifikuara në planin e veprimit dhe në mënyrë të veçantë të sigurojë që objektivat për humbjet dhe arkëtimet janë realizuar për çdo tremujor në fund të tremujorit;

d) do të kërkojë, kur është e nevojshme dhe në përputhje me procedurat përkatëse të shtjelluara në legjislacionin shqiptar, autoritetit rregullator përkatës të Garantuesit të rristrukturojë kostot e tarifave të tij për konsumatorin për të arritur mbulimin e gjerë të kostove të tij mbi baza tremujore, dhe në minimum në përputhje me planin e veprimit deri atëherë në fuqi;

e) do të zbatojë, mbi bazat e një kontrate asistuese menaxhimi, programin e asistencës bashkëmenaxhues në një mënyrë të pranueshme për Bankën gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit;

f) do të përgatisë, mbi bazat e një guidelines të pranueshme për Bankën, dhe t'i sigurojë Bankës, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës këtu ose një date tjetër të mëvonshme siç mund të bihet dakord për këtë qëllim ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit, një plan për operimin e ardhshëm të projektit dhe t'i sigurojë Bankës një mundësi për të shkëmbyer pikëpamjet me Huamarrësin mbi planin në fjalë;

g) do të themelojë një ent plotësisht të sajën përpara 31 dhjetorit 2005 me synimin që një ent i tillë do të zotërojë dhe operojë termocentralin e Vlorës, dhe t'i transferojë këtij enti të gjitha asetet dhe përgjegjësitë (me përjashtim të Huasë që do të sigurohet nga Banka sipas kësaj marrëveshjeje dhe huave që do të sigurohen nga bashkëfinancuesit për këtë projekt) lidhur me termocentralin e Vlorës dhe të hyjë në një marrëveshje për blerje energjie me këtë ent, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën, dhe të asistojë këtë ent, përpara 31 dhjetorit 2006, duke bërë një kontratë të pranueshme për Bankën, për operimin e termocentralit të Vlorës për tre vitet në vijim, ose për çdo periudhë tjetër për të cilën mund të bihet dakord me Bankën;

h) do të krijojë fondin balancues përpara 31 dhjetorit 2004.

Paragrafi 3.02 Njësia e zbatimit të projektit

a) me qëllim që të koordinojë, menaxhojë, monitorojë dhe vlerësojë të gjitha aspektet e zbatimit të projektit, përfshirë prokurimin e mallrave, punimet dhe shërbimet për projektin, Huamarrësi përveçse kur është rënë dakord ndryshe me Bankën, do të krijojë dhe gjatë gjithë kohës gjatë ekzekutimit të projektit operojë një njësi menaxhimi projekti me burime të mjaftueshme dhe me personel të kualifikuar si duhet, përfshirë midis të tjerave një nëpunës financiar dhe një nëpunës prokurues, sipas termave të referencës të pranueshëm nga Banka.

b) Huamarrësi sipas termave të referencës të pranueshme nga Banka, do të mbajë konsulentë menaxhues projekti gjithë kohën gjatë ekzekutimit të projektit për të asistuar PMU me:

1. shqyrtimin dhe finalizimin e parapërgatitjeve prokuruese, përfshirë dokumentet e tenderit;
2. procesin e tenderimit;
3. raportimin e saktë dhe të vazhdueshëm;
4. monitorimin dhe përmirësimin e shumës rezervë të projektit lokal;
5. monitorimin e llogarisë së projektit lokal;
6. ekzekutimin e plotë të projektit.

Paragrafi 3.03. Prokurimi

Për qëllimet e paragrafit 4.03 të kushteve dhe termave standarde, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, klauzolat e mëposhtme do të udhëheqin prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huasë:

a) Mallrat, punimet dhe shërbimet do të prokurohen me tenderim të hapur në përputhje me rregullat e prokurimit të BERZH-it, me përjashtim të kontratës së ndërtimit, e cila do të financohet nga bashkëfinancuesit dhe e cila do të tenderohet në përputhje me udhëzimet e prokurimit të IDA-s dhe me procedurat e IDA-s për tender ndërkombëtar. IDA do të ketë përgjegjësinë kryesore për koordinimin e monitorimit dhe rishikimit të procedurave të prokurimit. BERZH dhe BEI do të rishikojnë dokumentat e tenderit të Huamarrësit, raportin e vlerësimit të tenderit dhe dokumentacionin e kontratës, përpara se t'i konfirmojnë drejtpërsëdrejti IDA-s se nuk kanë vërejtje për to.

b) Për qëllimet e paragrafit 3.03 (a), procedurat për tenderin e hapur jepen në kapitullin 3 të rregullave të prokurimit të BERZH-it.

Paragrafi 3.04 Marrëveshjet për mjedisin

Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafëve 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të kushteve dhe termave standarde, Huamarrësi:

a) përveçse kur është specifikuar ndryshe në planin e veprimit të mjedisit, do të zbatojë projektin në përputhje me standardet dhe rregullat e ambientit në fuqi herë pas here në juridiksionin në të cilin është lokalizuar projekti dhe me standardet e ambientit që ekzistojnë në Bashkimin Europian në datën e kësaj Marrëveshjeje (ose, në rast se këto standarde nuk ekzistojnë në Bashkimin Europian, ashtu siç janë paraqitur në manualin e aplikueshëm për mjedisin të Grupit të Bankës Botërore);

b) do të zbatojë me seriozitet dhe t'i përmbahet planit të veprimit për mjedisin;

c) në dorëzimin e projektit dhe çdo dy vjet paskëta, do të organizojë, me shpenzimet e saj, që të kryhet një auditim i ambientit për të gjitha operacionet e Huamarrësit (përfshirë, por jo e kufizuar për projektin) nga një ekspert për ambientin i pavarur, i emëruar nga Huamarrësi sipas termave të referencës, të kënaqshme për Bankën, dhe në vijim të çdo auditimi të tillë, nëse kështu e kërkon Banka, të ndryshojë planin e veprimit për mjedisin duke marrë parasysh çdo problem të ngritur nga ky auditim.

Paragrafi 3.05 Konsulentët

a) Me qëllim që të asistojë në zbatimin e projektit, Huamarrësi, përveçse kur është rënë dakord ndryshe me Bankën, do të punësojë ose të bëjë që të punësohet, siç kërkohet, dhe të përdorë konsulentet, duke përfshirë, por jo kufizuar, një konsulent monitorimi për mjedisin për projektin, kualifikimet, eksperiencat dhe termat e referencës të të cilit të jenë të kënaqshme për Bankën.

b) Huamarrësi do të sigurojë, pa pagesë, për çdo konsulent të angazhuar për të asistuar në problemet që lidhen me projektin ose me operacionet e Huamarrësit lehtësira dhe suport të nevojshëm për të kryer funksionet e tyre, përfshirë dhe hapësirat për zyra, si edhe të gjitha dokumentet, materialet dhe çdo informacion tjetër që mund të ketë lidhje me punën e tyre.

Paragrafi 3.06 Programi i asistencës së bashkëmenaxhimit

Huamarrësi do të krijojë dhe do të mbajë programin e asistencës së bashkëmenaxhimit, sipas termave dhe kushteve të pranueshme për Bankën, me anën e të cilit Huamarrësi do të kontrakttojë me një shërbim të huaj privat për të siguruar një ekip bashkëmenaxhuesish që do të kryejë detyra të caktuara për të përmirësuar të gjitha aspektet e operacioneve të Huamarrësit.

Paragrafi 3.07 Frekuenca e raportimit dhe kërkesat e arbitrazhit

a) Derisa shuma e plotë e Huasë të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës raportet vjetore mbi mjedisin, shëndetin e punëtorëve dhe problemet e sigurisë në lidhje me operacionet e Huamarrësit (duke përfshirë projektin pa asnjë kufizim) siç përmendet në paragrafin 5.02 (c)(iii) të kushteve dhe termave standarde, brenda 90 ditëve pas përfundimit të vitit për të cilin raportohet. Këto raporte do të përfshijnë informacione mbi problemet e veçanta si vijon:

1. Informacion mbi përputhjen nga Huamarrësi me standardet dhe rregullat për mjedisin në fuqi herëherës në juridiksionin në të cilin është lokalizuar projekti dhe me standardet për mjedisin që ekzistojnë në Bashkimin Europian në datën e kësaj Marrëveshjeje (ose, në rast se këto standarde nuk ekzistojnë në Bashkimin Europian, ashtu siç janë paraqitur në manualin e aplikueshëm për mjedisin e Grupit të Bankës Botërore); përfshirë dhe statusin e lejeve për mjedisin të kërkuara për projektin, rezultatet e cילו inspektimi të kryer nga autoritetet për mjedisin, çfardo dhunimi të rregullave dhe standardeve të mjedisit dhe veprimet rregulluese që kanë lidhje me ato dhe çfarëdo gjobe të

imponuar për dhunime të tilla;

2. Informacion mbi zbatimin e planit të veprimit për mjedisin, duke përfshirë çfarëdo ndryshimi të propozuar për veprimet, afatet ose kostot;

3. Një përmbledhje të çfarëdo njoftimi material, raporteve dhe komunikimeve të tjera mbi problemet e ambientit të parashtruara nga Huamarrësi i cilido autoritet të mjedisit;

4. Informacion mbi shëndetin dhe të dhënat e sigurisë së projektit, duke përfshirë shkallën e aksidenteve dhe çfarëdo iniciative që ka lidhje me shëndetin dhe problemet e sigurisë të cilat janë zbatuar ose planifikuar nga Huamarrësi;

5. Një përmbledhje të çfarëdo ndryshimi të ligjeve mbi sigurinë, shëndetin dhe mjedisin të cilat mund të kenë efekt material mbi operacionet e Huamarrësit ose mbi projektin; dhe

6. Kopje të informacionit për mjedisin e paraqitur periodikisht nga Huamarrësi aksionerëve të tij ose opinionit publik.

b) Huamarrësi do të paraqesë raportet periodike të projektit siç referohet në paragrafin 4.04(a)(iv) të kushteve dhe termave standarde çdo tremujor, brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës që raportohet, derisa të përfundojë projekti. Këto raporte do të përfshijnë karakteristikat e veçanta që vijnë:

1. Informacionin e përgjithshëm si vijon:

A) Progresin fizik të arritur në zbatimin e projektit në datën e raportimit dhe gjatë periudhës së raportimit;

B) Vështirësitë aktuale ose të parashikuara, ose vonesat në zbatimin e projektit dhe efektin e tyre në afatet e zbatimit dhe hapat konkrete të ndërmarra ose të planifikuara për të kapërcyer vështirësitë dhe për të evituar vonesat;

C) Ndryshimet e parashikuara në datën e përfundimit të projektit;

D) Ndryshimet kyçe të personelit në stafin e PMU, konsulentët ose kontraktorët;

E) Çështje që mund të ndikojnë në koston e projektit; dhe

F) Çdo zhvillim apo veprimtari që ka gjasë të ndikojë mbijetesën ekonomike të çdo pjese të projektit.

2. Një tabelë progresi tip diagrame, të bazuar në afatet e zbatimit të projektit që të tregojë ecurinë në secilën pjesë të projektit dhe ku të përfshihet një grafik i shpenzimeve aktuale dhe të planifikuara.

3. Deklarate financiare që të tregojë detajet e shpenzimeve të bëra në çdo pjesë të projektit dhe tërheqjet, bashkë me një deklaratë ku të tregohen:

A) Vlerësimet e koston fillestare;

B) vlerësimet e koston të rishikuara, nëse ka, me arsyet për ndryshim;

C) shpenzimet e vlerësuara fillestare dhe shpenzimet e tanishme të datës;

D) arsyet për ndryshimet e shpenzimeve të tanishme të datës shpenzimet e vlerësuara fillestare të datës; dhe

E) shpenzimet e vlerësuara për tremujorin e mbetur të vitit.

4. Një deklaratë e shkurtër e statusit të përputhshmërisë me secilën nga marrëveshjet që përmban kjo Marrëveshje.

5. Një deklaratë të shkurtër të statusit të llogarisë së shërbimit të borxhit dhe llogarisë së projektit lokal.

6. Çdo informacion tjetër i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka.

c) menjëherë me ndodhjen e ndonjë incidenti apo aksidenti që ka lidhje me Huamarrësin ose projektin i cili mund të ketë efekt të pafavorshëm material mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, Huamarrësi do t'i japë njoftim Bankës për këte me faksimile ose teleks duke specifikuar natyrën e incidentit apo aksidentit dhe hapat që po ndërmerr Huamarrësi për rikuperimin e tyre. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër, një incident apo aksident ka gjasa të ketë efekte të këqija materiale mbi mjedisin, shëndetin apo sigurinë, nëse ndonjë ligj i aplikueshëm kërkon njoftim për incidentin apo aksidentin në autoritetet qeverisëse, një incident apo aksident i tillë përfshin fatalitet ose dëmtime serioze të shumta që kërkojnë shërbim mjekësor, një incident apo aksident i tillë është bërë i njohur në publik nga media apo të tjera.

Paragrafi 3.08 Llogaritë e projektit

a) Huamarrësi do të hapë, për qëllimet e projektit, dhe mbajë deri në shkarkimin e plotë të çfarëdo dhe të gjitha detyrimeve të Huamarrësit në këtë Kontratë, një llogari depozituese të veçantë të emërtuar në monedhën e huasë (Llogaria e shërbimit të borxhit) në një bankë tregtare të pranueshme nga Banka mbi terma dhe kushte të kënaqshme për Bankën, ku të përfshihet mbrojtja e duhur ndaj zëvendësimit të humbjeve, konfiskimit dhe sekuestrimit dhe të autorizojë këtë bankë tregtare që t'i ofrojë Bankës akses të menjëhershëm në çdo kohë në të gjithë dokumentacionin dhe deklaratat e saj në lidhje me llogarinë e shërbimit të borxhit. Mbas datës efektive, Huamarrësi do të mbajë në llogarinë e shërbimit të borxhit një balancë minimale të barabartë me shumën e rezervës së shërbimit të borxhit. Huamarrësi mund të tërheqë shuma nga llogaria e shërbimit të borxhit me qëllim për të bërë pagesat e duhura sipas Marrëveshjes së huasë.

b) Huamarrësi do të hapë, për qëllimet e projektit dhe do të mbajë, deri sa të përfundojnë punimet ndërtuese sipas Projektit, një llogari depozituese të veçantë të emërtuar në lekë (Llogaria e projektit lokal) në një bankë tregtare të pranueshme nga Banka mbi terma dhe kushte të kënaqshme për Bankën, ku të përfshihet mbrojtja e duhur ndaj zëvendësimit të humbjeve, konfiskimit dhe sekuestrimit, dhe të autorizojë këtë bankë tregtare që t'i ofrojë Bankës akses të menjëhershëm në çdo kohë në të gjithë dokumentacionin dhe deklaratat e saj në lidhje me llogarinë e projektit lokal. Mbas datës efektive, Huamarrësi do të mbajë në shërbimit të borxhit, në llogarinë e projektit lokal një balancë minimale të barabartë me shumën e rezervës së projektit lokal.

Neni 4

Marrëveshjet financiare dhe operacionale

Paragrafi 4.01 Raportet dhe të dhënat financiare

a) Huamarrësi do të instalojë me kujdes dhe me shpejtësi, dhe më pas do të mbajë, një sistem kontrolli të kostos dhe kontabilitetit dhe sistemin e informacionit të menaxhimit të kënaqshëm për Bankën.

b) Huamarrësi do të mbajë procedurat, të dhënat dhe llogaritë adekuate për të paraqitur një pamje të qartë dhe reale të kushteve financiare të Huamarrësit dhe enteve të tij dhe rezultatet e operacioneve të tij, në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuara në tërësi dhe të mjaftueshme për të monitoruar dhe regjistruar progresin e projektit (përfshirë koston dhe dobitë që rrjedhin nga ajo).

c) Huamarrësi:

1. do të ketë të dhënat e tij, llogaritë dhe deklaratat financiare (përfshirë bilancin, deklaratën e të ardhurave, deklaratën e fluksit të parave dhe shënime të tjera lidhur me këtë), përfshirë ato që kanë lidhje me llogarinë e shërbimit të borxhit dhe llogarinë e projektit lokal, dhe dokumentet, llogaritë dhe deklaratat financiare të Enteve të tij, për çdo vit fiskal të audituar nga auditues të pavarur të pranueshme për Bankën në përputhje me GAAP; këta auditues të pavarur do të jenë anëtarë të një njësie kontabiliteti profesional që është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

2. do t'i sigurojë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të cilitdo muaj, raportin operacional i cili do të përfshijë, midis të tjerave, raportimin specifik mbi performancën ballafaquar me planin e veprimit then in effect fort he month so ended, prodhuar nga ose në bashkëpunim me entin e kontraktuar sipas programit të asistencës bashkëmenaxhimit me detaje të mjaftueshme që të lejojnë Bankën të përcaktojë nëse janë realizuar objektivat tremujore të planit të veprimit.

3. do t'i sigurojë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj mbas përfundimit të çdo viti fiskal:

A) kopje të certifikuara të deklaratave të saj financiare për vitin fiskal të audituar (duke përfshirë dhe deklarata financiare të veçanta të entit që do zotërojë dhe operojë termocentralin e Vlorës);

B) raportin e këtij auditimi të bërë nga këta auditues të këtij niveli dhe me një detajim të tillë siç mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka;

C) një deklaratë të të gjitha transaksioneve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe secilit nga entet dhe filialet e tij;

D) një deklaratë që tregon se është mbajtur koeficienti i mbulimit të shërbimit të borxhit, specifikuar në paragrafin 4.03 më poshtë;

E) planin e investimit dhe planin e biznesit për tre vitet që vijojnë;

F) një raport nga audituesit ku të certifikohet që Huamarrësi ka vepruar në përputhje me marrëveshjet financiare që përmban paragrafi 4.03 deri në fund të vitit fiskal përkatës ose, siç mund të jetë rasti, mospërputhjet e detajuara.

4. Do t'i sigurojë Bankës informacion tjetër të kësaj natyre në lidhje me dokumente të tilla, llogari dhe deklarata financiare dhe auditimin e tyre, siç mund ta kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme Banka.

Paragrafi 4.02 Marrëveshjet financiare negative

a) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe, cilindo nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin lidhur me këtë, siç mund ta kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme:

1. Të hyjë në ndonjë marrëveshje apo bashkëpunim, të garantojë ose në çfarëdo mënyre apo sipas çfarëdo kushti të jetë e obliguar për të gjithën ose ndonjë pjesë të çfarëdo detyrimi financiar apo tjetër detyrimi të një personi tjetër, përfshirë cilindo ent apo filial.

2. Të hyjë në çfarëdo transaksioni me cilindo person, përveçse në ecurinë e zakonshme të biznesit mbi terma komercialë të zakonshëm dhe mbi bazën e bashkëpunimeve të largëta (arms length), ose të themelojë cilindo agjenci të vetme dhe ekskluzive shitjesh ose blerjesh, ose të hyjë në çfarëdo transaksioni me anën e të cilit Huamarrësi mund të paguajë më shumë sesa çmimi komercial i zakonshëm për çfarëdo blerje ose mund të marrë më pak sesa çmimi komercial për full ex-works (sipas skontos së tregut normal) për produktet ose shërbimet e saj.

3. Të hyjë në ndonjë partneritet, me ndarje fitimesh apo marrëveshje qiraje ose në plane të tjera të ngjashme me anën e të cilave të ardhurat ose fitimet e Huamarrësit janë ose mund të ndahen me një person tjetër.

4. (Vullnetarisht ose jo) të bëjë çfarëdo parapagimi, riblerje ose shlyerje të parakohshme të çfarëdo borxhi ose të bëjë parapagim të çfarëdo borxhi në pajtim me çdo klauzolë të çfarëdo marrëveshjeje ose notë e cila kushtëzon direkt ose indirekt përsheptimin e parapagimit në kohë dhe sasi, përveçse në ndonjë rast të tillë, nëse Banka e kërkon në mënyrë të tillë, Huamarrësi në të njëjtën kohë bën një parapagim proporcional të shumës së princialit deri atëherë e papaguar e huasë në përputhje me klauzolat e paragrafit 3.07 të termave dhe kushteve standarde (me përjashtim të rastit kur shuma e çfarëdo parapagimi të tillë nuk do t'u nënshtrohet kërkesave të shumës minimale të parapagimit).

5. Të shesë ose të transferojë të gjitha ose një pjesë të rëndësishme të aseteve të saj (me një transaksion ose një seri transaksionesh, të lidhura ose ndryshe), me kusht që, megjithatë, Banka nuk do ta mbajë ose vonojë në mënyrë të paarsyeshme miratimin e saj, lidhur me veprimet e kërkuara në pajtim me deklaratën e politikës së sektorit energjetik.

6. Të ndërmarrë ose të lejojë çfarëdo shkrirje firmash, konsolidim apo riorganizim, me kusht që, megjithatë, Banka nuk do ta mbajë ose vonojë në mënyrë të paarsyeshme miratimin e saj lidhur me veprimet e kërkuara në pajtim me deklaratën e politikës së sektorit energjetik:

b) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, nëse nuk e informon Bankën së paku 30 ditë para, cilindo nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin siç mund ta kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme:

1. Të hyjë në çfarëdo kontrate menaxhimi apo bashkëpunimi të ngjashëm me anën të të cilës bizneset apo operacionet e saj menaxhohen nga cilindo person tjetër, duke përfshirë cilindo ent ose filial (përveç kontratave të filluara lidhur me programin e asistencës së bashkëmenaxhimit të pranueshme nga Banka) ose

2. Të formojë cilindo ent ose të bëjë ose të lejojë të ekzistojnë hua ose paradhënie për, ose depozita me (përveç depozitave në zhvillimin e zakonshëm të biznesit me bankat me emër), persona

të tjerë ose investime në cilindo person, duke përfshirë çfarëdo enti ose filiali; me kusht që, megjithatë, Huamarrësi do të jetë i lirë të investojë në kategorinë e investimit afatshkurtër të letrave me vlerë të tregtueshme vetëm t'u japë përdorim të përkohshëm burimeve të veta.

Paragrafi 4.03 Marrëveshje të tjera financiare

Pa kufizuar përgjithësimin e paragrafit 4.02, Huamarrësi do të mbajë, në çdo kohë, një koeficient të mbulimit të shërbimit të borxhit prej së paku 1.25.

Paragrafi 4.04. Drejtimi i biznesit dhe operacioneve

Huamarrësi, përveçse kur Banka bie dakord ndryshe:

a) Do të drejtojë biznesin dhe operacionet në përputhje me standardet dhe praktikën e shëndosha administrative financiare dhe inxhinierike të njohura botërisht, duke i dhënë konsideratën e duhur faktorëve ekologjikë dhe mjedisorë dhe shëndetit dhe sigurisë publike, dhe me konsideratën e nevojshme për të gjitha politikën principale operuese.

b) Do të ndërmarrë menjëherë të gjitha veprimet brenda aftësive të tij për të ruajtur ekzistencën e tij ligjore, të vazhdojë operacionet e tij dhe të sigurojë, të mbajë dhe të rimarrë të gjitha të drejtat, pasuritë, fuqitë, privilegjet dhe franshizat që janë të nevojshme për të drejtuar biznesin e tij, duke përfshirë dhe vazhdimin e projektit.

c) Të mos shesë ose japë me qira cilindo nga asetet e tij që duhen për të vazhduar me efikasitet operacionet e tij, ose heqja e të cilave mund të paragjykojë aftësinë e tij për të kryer në mënyrë të kënaqshme çdonjerën nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) Do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo propozim për t'u ndryshuar, pezulluar ose shfuqizim të çfarëdo klauzole të statutit dhe t'i japë Bankës një mundësi adekuate për të komentuar një propozim të tillë para se të ndërmarrë ndonjë veprim theon.

e) Do të bëjë dhe të mbajë me siguri të përgjegjshëm, ose do të krijojë klauzola të tjera të kënaqshme për Bankën lidhur me, sigurimet ndaj rreziqeve të tilla të humbjes, dëmtimit dhe përgjegjësisë dhe në shuma të tilla që përputhen me praktikën e duhur:

f) në çdo kohë do t'i verë në punë dhe do t'i mirëmbajë centralet e tij, impiantet, pajisjet dhe çdo pronë tjetër në kushte të mira pune dhe, menjëherë kur të jetë e nevojshme, të bëjë të gjitha riparimet e nevojshme dhe restaurimet e tyre, gjithçka në përputhje me biznesin e shëndetshëm dhe praktikën financiare.

Neni 5

Pezullimi, përshpejtimi, anulimi

Paragrafi 5.01 Pezullimi

Si vijon janë përcaktuar saktë për qëllimet e paragrafit 7.01(a)(xiv) të termave dhe kushteve standarde:

a) Kuadri legjislativ dhe rregullator i aplikueshëm për sektorin e energjisë në territorin e Garantuesit do të jetë ndryshuar, pezulluar, abroguar shfuqizuar ose hequr dorë, përveçse, nëse veprime të tilla, sipas gjykimit të vetë Bankës, përputhen me ato të përcaktuara në planin e veprimit ose në deklaratën e politikës së sektorit energjetik;

b) Statutet do të jenë ndryshuar, pezulluar, abroguar, shfuqizuar ose hequr dorë, përveçse nëse veprime të tilla, sipas gjykimit të vetë Bankës, përputhen me ato të përcaktuara në planin e veprimit ose në deklaratën e politikës së sektorit energjetik;

c) Huamarrësi do të ketë ndërmarrë cilindo nga veprimet e përmendura në paragrafin 4.02.(b) në mënyrë të tillë që të ndikojë materialisht dhe për të keq operacionet ose kushtet financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të vazhduar projektin ose për të realizuar secilën nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

d) Kontrolli i Huamarrësit do t'i jetë transferuar një pale tjetër, përveç Garantuesit;

e) E drejta e Huamarrësit për të tërhequr të ardhura sipas secilës nga Marrëveshjet e bashkëfinancimit ose (1) do të ketë dështuar për t'u bërë efektive më 31 dhjetor 2004 ose në një datë tjetër siç bie dakord Banka, ose (2) ose është pezulluar, anuluar, ose përfunduar në tërësi ose pjesërisht në pajtim me termat e një Marrëveshjeje të tillë bashkëfinancimi, nëse në secilin rast Huamarrësi nuk vendos me pëlqimin e Bankës që fondet adekuate për projektin janë të

disponueshme për Huamarrësin nga burime të tjera sipas termave dhe kushteve në pajtim me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 5.02 Përshpejtimi i maturimit

Si vijon janë specifikuar për qëllimet e paragrafit 7.06(f) të kushteve dhe termave standarde:

- a) secila nga ngjarjet e referuara në paragrafin 5.01;
- b) çdo mosplotësim që është shfaqur dhe që do të vazhdojë sipas çdo marrëveshje bashkëfinancimi.

Neni 6 Efektiviteti

Paragrafi 6.01 Kushtet paraprake të bërjes efektive

Si vijon janë specifikuar për qëllimet e paragrafit 9.02(c) të kushteve dhe termave standarde si kushte suplementare në efektshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së garancisë:

- a) Marrëveshjet e bashkëfinancimit janë zbatuar dhe livruar dhe të gjitha kushtet para efektshmërisë së tyre ose të drejtës së Huamarrësit për të bërë tërheqje, janë plotësuar, përveçse efektshmërisë së kësaj Marrëveshjeje;
- b) Marrëveshja e garancisë do të jetë ratifikuar nga parlamenti i Garantuesit;
- c) Plani i veprimit do të jetë rënë dakord dhe bërë efektiv, dhe të jetë materialisht në formën e aneksit 1 në këtë Marrëveshje;
- d) Të jetë caktuar kontrata e asistencës së bashkëmenaxhimit, që do të zbatojë programin e asistencës së bashkëmenaxhimit, në formë dhe përmbajtje e kënaqshme për Bankën;
- e) Të jetë adoptuar plani i veprimit për mjedisin;
- f) Të jetë themeluar PMU në një mënyrë të kënaqshme për Bankën;
- g) Huamarrësi do të ketë zgjedhur dhe caktuar një konsulent menaxhues projekti i kënaqshëm për Bankën për të asistuar PMU-në në zbatimin e gjithë projektit deri sa të mbarojë projekti;
- h) Huamarrësi do të ketë zgjedhur dhe caktuar një konsulent monitorues për ambientin për projektin të kënaqshëm për Bankën;
- i) Huamarrësi do të ketë instaluar ose krijuar një operator të sistemit të transmetimit që plotëson kërkesat e Memorandumit të Mirëkuptimit në Tregun Energjetik Rajonal në Europën Jug-lindore;
- j) Huamarrësi të ketë marrë të gjitha licencat dhe lejet e kërkuara për të ndërtuar dhe operuar termocentralin dhe entet drejtuese aplikuese shqiptare i kanë konfirmuar Bankës që Huamarrësi ka marrë të gjitha licencat dhe lejet e tilla të kërkuara;
- k) Të kenë rënë dakord me Bankën për afatin e zbatimit të projektit dhe strategjinë kontraktuese;
- l) Deklarata e politikës së sektorit energjetik do të mbetet në fuqi të plotë dhe efekt;
- m) Llogaria e projektit lokal dhe llogaria e mbulimit të borxhit do të jenë hapur në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën;
- n) Garantuesi do t'i ketë konfirmuar skedulin e ripagesës për borxhet e prapambetura të institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore Huamarrësit në pajtim me planin e veprimit;
- o) Garantuesi do t'i ketë konfirmuar një plan për eliminimin e subvencioneve Huamarrësit në përputhje me planin e veprimit.

Paragrafi 6.02 Opinionet ligjore

a) Për qëllimet e paragrafit 9.03(a) të termave dhe kushteve standarde, opinionit ose opinionet ligjore do të jepen në emër të Huamarrësit nga drejtori i departamentit juridik të Huamarrësit;

b) Për qëllimet e paragrafit 9.03(b) të termave dhe kushteve standarde, opinionit ose opinionet ligjore do të jepen në emër të Garantuesit nga Ministri i Drejtësisë.

Paragrafi 6.03 Përfundimi i afatit për bërjen efektive

Data 180 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllimet e paragrafit 9.04 të kushteve dhe termave standarde.

Neni 7
Të ndryshme

Paragrafi 7.01 Njoftime

Adresat që vijojnë janë specifikuar për qëllimet e paragrafit 10.01 të kushteve dhe termave standarde:

Për Huamarrësin:

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare

Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Albania

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm

Fax +355 42 32046

Për Bankën

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square, London EC2A 2JN, UK

Në vëmendje të Operation Administration Unit

Fax +44-0-7338-6100

Telex 8812161

Answerback: EBRD L G

Në cilësinë e deshmitarit, palët në këtë Marrëveshje që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje në Tiranë, Republika e Shqipërisë në ditën dhe vitin e shkruar më sipër.

KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE

Nga:-----

Emri: Z.Andis Harasani; Titulli: Drejtor i Përgjithshëm

BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: -----

Emri: Z. Tony Marsh; Titulli: Drejtor

SHTOJCA 1-PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është të ndihmojë Huamarrësin në përmirësimin e furnizimit me energji në Shqipëri duke rritur kapacitetin gjenerues të energjisë dhe duke shtuar impiantet e gjenerimit të energjisë, duke ndihmuar në këtë mënyrë për të mbajtur rezervat ujore në nivele ku impiantet hidrike operojnë me efikasitet të plotë, si edhe reduktimin e varësisë së Huamarrësit nga kushtet hidrologjike për gjenerimin e elektricitetit dhe reduktimit të varësisë së tij nga importi i energjisë, duke përmirësuar në këtë mënyrë sigurinë e furnizimit me energji për konsumatorët dhe duke reduktuar nevojën e load shedding nga Huamarrësi.

2. Projekti kërkon ndërtimin e një termocentrali me një cikël të ri të kombinuar, me naftë, të vendosur në Vlorë dhe përbëhet nga pjesët vijuese të paraqitura më poshtë dhe u nënshtrohet atyre modifikimeve që mund të bjerë dakord herë pas here Banka me Huamarrësin.

Pjesa A Termocentral me cikël të kombinuar

1. Ndërtimi i një termocentrali me cikël të kombinuar (Termocentrali Vlorë) në një sipërfaqe 6 hektarë rreth 6 km në veri të Vlorës, Shqipëri pranë një terminali naftë.

2. Rehabilitimi i terminalit të tankerit të naftës dhe lidhja me rrjetin e transmetimit.

Pjesa B Asistenca teknike (financuar nga IDA).

1. Sigurimi i asistencës teknike Huamarrësit për zbatimin e projektit, përmirësimin e operimit të Huamarrësit dhe reformat e sektorit;

2. Sigurimi i trajnimit për Huamarrësin në menaxhimin e prokurimeve dhe të mjedisit;

3. Projekti parashikohet të përfundojë në 31 dhjetor 2007.

SHTOJCA 2 - KATEGORITË DHE TËRHEQJET

Tabela bashkëlidhur kësaj shtojce paraqet kategoritë, shumën e huasë së dhënë për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohet në çdo kategori.

Lidhje e shtojcës 2

Kategoritë	Shuma e kredisë së alokuar në monedhën e kredisë	Përqindja e shpenzimeve (pa taksat dhe detyrimet) për t'u financuar
1) Mallra dhe shërbime për pjesën A	39 600 000	Deri në 37.5% të vlerës së kontratës që është subjekti i tenderit ndërkombëtar*
3) Komisioni Front-end	400 000	100%
Gjithsej	40 000 000	

* Kjo përqindje bazohet në vlerën e parashikuar të kontratës dhe do të ndryshohet pas nënshkrimit të kontratës

LIGJ
Nr.9311, datë 11.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA), PËR PROJEKTIN E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e menaxhimit të burimeve ujore, në shumën 10 200 000 (dhjetë milionë e dyqind mijë) SDR”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4408, datë 25.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE KREDIE PËR ZHVILLIM

(Projekti i menaxhimit të burimeve ujore)
ndërmjet SHQIPËRISË DHE SHOQATËS PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
29 korrik 2004

MARRËVESHJE, datë 29 korrik 2004, ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar (Shoqata).

Meqënëse (A) Huamarrësi ka kërkuar nga Shoqata të asistojë në financimin e projektit, pasi ka mbetur i kënaqur në lidhje me studimin paraprak dhe prioritetin e projektit të përshkruar në kapitullin 2 të kësaj Marrëveshjeje,

meqënëse Shoqata ka rënë dakord ndërmjet të tjerash dhe në bazë të sa është përmendur më lart, t'i japë kredi Huamarrësit bazuar në termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, për sa më sipër, palët kanë rënë dakord:

Neni 1

Kushte të përgjithshme, përkufizime

Seksioni 1.01 “Kushtet e përgjithshme që zbatohen për marrëveshjet e kredive” të Shoqatës, datë 1 janar 1985 (me ndryshimet e pasqyruara deri në 6 tetor 1989) (kushte të përgjithshme), janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.02 Nëse nuk kërkohet ndryshe nga konteksti, disa terma të dhëna në kushtet e përgjithshme kanë kuptime përkatëse të përcaktuara aty dhe termat e shtuara më poshtë kanë kuptimet e mëposhtme:

- a) “Përfitues” ose “përfituesit” nënkuptojnë FSHPU-të, SHPU-të dhe bordet e kullimit, të cilat do të identifikohen dhe do të marrin pjesë në zbatimin e projekteve në shtojcën A.1 të projektit;
- b) “Bordet e kullimit” nënkuptojnë bordet e kullimit të krijuara në bazë të dispozitave të kapitullit 5 të ligjit të ujitjes dhe kullimit;
- c) “PMM” nënkupton planin e menaxhimit të mjedisit, datë 13 shkurt 2004, i kënaqshëm për shoqatën, që përcakton procedurat dhe masat për të zbutur ndikimet negative në mjedis dhe masat monitorizuese për shtojcën A.1 të projektit, i cili mund të ndryshohet herë pas here me miratimin e Shoqatës;
- d) “Raporti i monitorimit financiar” ose “RMF” nënkupton çdo raport të përgatitur në përputhje me seksionin 4.02 të kësaj Marrëveshjeje;
- e) “FSHPU” nënkupton Federatën e Shoqatave të Përdoruesve të Ujit, themeluar sipas dispozitave të kapitullit 4 të ligjit të ujitjes dhe kullimit;
- f) “Ligji i ujitjes dhe kullimit” nënkupton ligjin nr.8518 të Huamarrësit, datë 30 korrik 1999;
- g) “MBU” nënkupton Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit të Huamarrësit ose vartës të saj;
- h) “Këshilli Kombëtar i Ujit” nënkupton Këshillin Kombëtar të Ujit të krijuar më 28 tetor, 1996 me vendim të Këshillit të Ministrave (vendim nr.775), si organ qendror vendimmarrës për administrimin e burimeve ujore të Huamarrësit;
- i) “UKSHPU” nënkupton Unionin Kombëtar të Shoqatave të Përdoruesve të Ujit, të krijuar më 19 prill, 2004, si një organ këshillimor për përfaqësimin e shpu-ve;
- j) “PIP” nënkupton planin e zbatimit të projektit për projektin, i datës 21 prill 2004, i cili mund të ndryshohet herë pas here në marrëveshje midis Shoqatës dhe Huamarrësit;
- k) “PMU” nënkupton njësinë e menaxhimit të projektit të krijuar sipas rregullores së MBU-së të datës 5 prill 1999;
- l) “Fondi paradhënës për përgatitjen e projektit” nënkupton grantin për fazën përgatitore të projektit që Shoqata i jep Huamarrësit në bazë të marrëveshjes të firmosur ndërmjet Shoqatës më 23 shtator 2003 dhe Huamarrësit më 10 prill 2004;
- m) “Këshilli i Baseneve të Lumenjve” nënkupton këshillat që do të krijohen në bazë të shtojcës B.2 (d) të projektit, përgjegjës për menaxhimin e zonave specifike të baseneve;
- n) “Llogaria speciale” nënkupton llogarinë e përmendur në seksionin 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje;
- o) “Komiteti drejtues” nënkupton komitetin që mbikëqyr zbatimin e projektit, si dhe monitorimin e progresit të reformës sektoriale;
- p) “Skema” nënkupton një projekt specifik që do të identifikohet nga përfituesi, që miratohet nga komiteti drejtues dhe zbatohet nga PMU-ja dhe përfituesi, duke përdorur pjesë të fondeve të kredisë sipas shtojcës A.1 të projektit;
- q) “Plan tranzicioni” nënkupton planin për transferimin e përgjegjësiave menaxheriale nga PMU-ja te njësitë dhe përfituesit përkatës dhe është përfshirë në PIP; dhe
- r) “SHPU” nënkupton shoqatat e përdoruesve të ujit, të krijuara në bazë të dispozitave të kapitullit 3 të ligjit të ujitjes dhe kullimit.

Neni 2 Kredia

Seksioni 2.01 Shoqata bie dakord t’i japë Huamarrësit, sipas kushteve të përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjen e Kredisë për Zhvillim, një shumë në monedha të ndryshme të barasvlefshme me dhjetë milionë e dyqind mijë special drawing (SDR 10 200 000).

Seksioni 2.02 (a) Shuma e kredisë mund të tërhiqet nga llogaria e kredisë në përputhje me dispozitat e kapitullit 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzime të bëra (ose, nëse bie dakord Shoqata,

që do të bëhen) për mallra, punime dhe shërbime të nevojshme për projektin dhe që do të financohen nga fondet e kredisë.

b) Huamarrësi, për qëllime të projektit, mund të hapë dhe të mbajë në dollarë një depozitë speciale në një bankë me kushte të kënaqshme për Shoqatën, duke përfshirë edhe mbrojtjen e duhur ndaj transaksioneve të paligjshme. Depozitimet në dhe pagesat nga llogaria speciale do të bëhen në përputhje me dispozitat e kapitullit 5 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Menjëherë pas datës efektive, Shoqata në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do t'i kthejë vetes shumën e kërkuar për të ripaguar shumën principale të fondit paradhënie për përgatitjen e projektit të tërhequr dhe të mbetur deri në këtë datë dhe të paguajë të gjitha tarifat e papaguara deri në këtë kohë. Teprica e patërhequr e shumës së autorizuar për fondin paradhënie për përgatitjen e projektit do të anulohet.

Seksioni 2.03 Data e mbylljes do të jetë 30 qershor 2009 ose një datë e mëvonshme e vendosur nga Shoqata. Shoqata do të njoftojë Huamarrësin menjëherë për datën e mëvonshme.

Seksioni 2.04 (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë përkushtimi mbi shumën principale të kredisë që nuk tërhiqet herë pas here, në një koeficient që do të përcaktohet nga Shoqata deri më 30 qershor të çdo viti, por nuk do të tejkalojë koeficientin prej $\frac{1}{2}$ të 1 % në vit.

b) Tarifa e përkushtimit do të rritet: (i) nga data 60 ditë pas datës së Marrëveshjes (data e rritjes) deri në datat përkatëse në të cilat Huamarrësi do të tërheqë shumat nga llogaria e kredisë ose deri në datën e anulimit; dhe (ii) në koeficientin e përcaktuar më 30 qershor që paraprin datën e rritjes dhe koeficientë të tjerë që mund të përcaktohen herë pas here sipas paragrafit (a) më lart. Koeficienti i përcaktuar më 30 qershor të çdo viti do të aplikohet nga data e ardhshme në vitin e përcaktuar në seksionin 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

c) Tarifa e përkushtimit do të paguhet: (i) në vendet që do të kërkojë Shoqata; (ii) pa kufizime të imponuara nga ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhën e specifikuar në këtë Marrëveshje për qëllime të seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme ose në një monedhë ose monedha të tjera të përshtatshme që mund të përzgjidhen herë pas here sipas udhëzimeve të këtij seksioni.

Seksioni 2.05 Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një tarifë shërbimi në koeficientin tre të katërtat e 1 % ($\frac{3}{4}$ e 1 %) në vit mbi shumën principale të kredisë së tërhequr herë pas here.

Seksioni 2.06 Tarifat e përkushtimit dhe tarifat e shërbimit do të paguhet çdo gjashtë muaj, më 15 prill dhe 15 tetor të çdo viti.

Seksioni 2.07 Huamarrësi do të ripaguajë shumën principale të kredisë në këste gjashtë mujore që paguhet në çdo 15 prill dhe 15 tetor duke filluar më 15 tetor 2014 dhe përfunduar më 15 prill 2024. Çdo kësht do të jetë pesë për qind (5%) e shumës principale.

Seksioni 2.08 Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përzgjidhet për qëllime të seksionit 4.02 të kushteve të përgjithshme.

Neni 3

Zbatimi i Projektit

Seksioni 3.01 a) Huamarrësi deklaron përkushtimin e tij për objektivat e projektit siç shprehet në kapitullin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe deri në përfundim do të zbatojë Projektin nëpërmjet njësisë së zbatimit të projektit (PMU) me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me praktikën e përshtatshme administrative, bujqësore, inxhinierike dhe mjedisore; dhe do të sigurojë, pa asnjë vonesë ashtu siç kërkohet, fondet, lehtësirat, shërbimet dhe burimet e tjera që kërkon projekti.

b) Pa pasur kufizim në dispozitat e paragrafit (a) të këtij neni dhe përveç rastit kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Huamarrësi do të ngarkojë PMU-në për zbatimin e projektit në përputhje me planin e zbatimit të projektit dhe programin e zbatimit që jepen në kapitullin 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02 Përveç rastit kur Huamarrësi dhe shoqata bien dakord ndryshe, prokurimi i

mallrave, punimeve civile dhe shërbimeve konsultive të kërkuara në projekt dhe të financuara nga shuma e kredisë do të kruhen sipas dispozitave të kapitullit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.03 Në lidhje me seksionin 9.06 të kushteve të përgjithshme dhe pa kufizime të përmendura si më lart, Huamarrësi:

a) do të përgatisë, në përputhje me udhëzuesit të pranueshëm për Shoqatën, dhe t'ia paraqesë Shoqatës, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së përfundimit ose të ndonjë date të mëvonshme për të cilën Huamarrësi dhe Shoqata kanë rënë dakord, një plan pune për aktivitete e projektit në të ardhmen dhe

b) do t'i krijojë Shoqatës mundësi të arsyeshme për shkëmbim pikëpamjesh me Huamarrësin në lidhje me planin e sipërpërmendur.

Neni 4

Konventat financiare

Seksioni 4.01 (a) Huamarrësi, nëpërmjet PMU-së, do të mbajë sistemin e menaxhimit të financave, përfshi kontabilizimet dhe llogaritë dhe të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me standardet financiare të aplikueshme të pranueshme nga Shoqata, të përshtatshme për pasqyrimin e aktiviteteve, burimeve dhe shpenzimeve të projektit.

b) Huamarrësi, nëpërmjet PMU-së:

i) duhet të bëjë auditimin për çdo vit fiskal (ose periudhë tjetër për të cilën Shoqata ka rënë dakord) të pasqyrave financiare të përmendura në paragrafin (a) të këtij seksioni, duke filluar me vitin fiskal kur është bërë aplikimi i parë për tëheqje për fondin paradhënës për përgatitjen e projektit, nga auditorë (revizorë) të pavarur të pranueshëm nga Shoqata, në përputhje me standardet e aplikueshme për auditimin, të pranueshëm për Shoqatën;

ii) duhet t'i paraqesë Shoqatës, sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj nga mbyllja e çdo viti (ose periudhë tjetër për të cilën Shoqata ka rënë dakord): (A) kopje të vërtetuara të pasqyrave financiare të përmendura në paragrafin (a) të këtij seksioni për vitin në fjalë (ose periudhë tjetër për të cilën Shoqata ka rënë dakord), të audituara dhe (B) një opinion të auditorëve mbi pasqyrat financiare, në shtrirje dhe me detaje të kënaqshme për Shoqatën; dhe

iii) duhet t'i paraqesë Shoqatës informacion në lidhje me kontabilizimet dhe llogaritë, auditimet e pasqyrave financiare, çështjet e ngritura nga auditorët sipas kërkesave të arsyeshme që Shoqata mund t'i bëjë herë pas here.

c) Për të gjitha shpenzimet për të cilat janë bërë kërkesat për tërheqje fondi nga llogaria e kredisë në bazë të pasqyrës së shpenzimeve, Huamarrësi nëpërmjet PMU-së:

i) do të ruajë, të paktën për një vit pasi Shoqata ka marrë raportin e auditimit për vitin fiskal nga i cili është bërë tërheqja e fundit nga llogaria kredisë, të gjitha kontabilizimet (kontratat, urdhrat, faturat dhe dokumentet e të tjerëve të cilët evidentojnë shpenzimet);

ii) do të mundësojë kontrollin e kontabilizimeve nga përfaqësuesit e Shoqatës; dhe

iii) do të sigurojë që pasqyrat financiare janë të përfshira në auditimin e çdo viti fiskal (ose periudhë tjetër kohore për të cilën Shoqata ka rënë dakord), sipas paragrafit (b) të këtij seksioni.

Seksioni 4.02 (a) Pa kufizime mbi detyrimet e raportimit të ecurisë së Huamarrësit të përcaktuara në paragrafin 1 të shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi nëpërmjet PMU-së do të përgatisë dhe dërgojë Shoqatës një raport monitorimi financiar në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Shoqatën, i cili:

i) përcakton burimet dhe përdorimet e fondeve për projektin si ato kumulative dhe të periudhës kur përgatitet raporti, paraqet fondet e ndara sipas kredisë dhe shpjegon ndryshimet ndërmjet përdorimeve aktuale dhe të planifikuara të fondeve;

ii) përshkruan përparimin fizik të zbatimit të projektit si atë kumulativ, dhe të periudhës kur përgatitet raporti, dhe shpjegon ndryshimet ndërmjet zbatimit aktual dhe të planifikuar të projektit; dhe

iii) përcakton gjendjen e prokurimeve të projektit deri në fund të periudhës kur përgatitet raporti;

b) Raporti i parë i monitorimit financiar do t'i dërgohet Shoqatës jo më vonë se 45 ditë pas

tremujorit të parë kalendarik pas datës efektive dhe do të mbulojë periudhën nga shfaqja e shpenzimeve të para të projektit deri në fund të tremujorit të parë kalendarik; prandaj çdo RMF do t'i dërgohet Shoqatës jo më vonë se 45 ditë pas çdo tremujori kalendarik pasardhës dhe do të mbulojë këtë tremujor.

Neni 5 **Ndërhyrje nga Shoqata**

Seksioni 5.01 Në vazhdim të Seksionit 6.02 (1) të kushteve të përgjithshme, janë specifikuar ngjarjet e tjera të mëposhtme:

a) Ligji i ujitjes dhe kullimit do të amendohet, pezullohet, abrogohet, shfuqizohet ose do të dekretohen dispozita të tjera ligjore, të cilat mund të ndikojnë, sipas opinionit të Shoqatës, materialisht dhe negativisht, në zbatimin e projektit;

b) plani i zbatimit të projektit do të amendohet, pezullohet, abrogohet, shfuqizohet ose do të dekretohen dispozita të tjera ligjore, të cilat mund të ndikojnë, sipas opinionit të Shoqatës, materialisht dhe negativisht, në zbatimin e projektit.

Seksioni 5.02 Në vazhdim të seksionit 7.01 (h) të kushteve të përgjithshme, ngjarjet e tjera janë specifikuar, emërtuar, në rast se ndodh ngjarja e specifikuar në seksionin 5.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6 **Ndërprerja**

Seksioni 6.01 Data 90 pas datës së Marrëveshjes, është përcaktuar në këtë mënyrë për qëllime të seksionit 12.04 të kushteve të përgjithshme.

Neni 7 **Përfaqësuesi i Huamarrësit, adresat**

Seksioni 7.01 Ministri i Financave i vendit Huamarrës është përcaktuar si përfaqësuesi i Huamarrësit për qëllime të seksionit 11.03 të kushteve të përgjithshme.

Seksioni 7.02 Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 11.01 të kushteve të përgjithshme:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave, Buleverdi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri

Faksimile: 355 42 28494

Për Shoqatën: International Development Association, 1818 H Street, N.W., Washington, D.C. 20433, United States of America

Adresa kabllore:

Indevas

Washington, D.C.

Telex:

248423 (MCI)ose

64145 (MCI)

Faksmile:

(202)477-6391

Në cilësinë e dëshmitarit, palët e sipërpërmendura, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar sipas rregullave, bëjnë të mundur firmosjen e kësaj Marrëveshjeje me emrat respektivë në Tiranë, Shqipëri, në datën dhe vitin e shkruar më lart.

Shqipëria

Prej Arben Malaj, përfaqësuesi i autorizuar

Shoqata për Zhvillimin Ndërkombëtar

Prej Nadir Mohammed, përfaqësuesi i autorizuar

KAPITULLI I TËRHEQJA E FONDEVE TË KREDISË

1. Tabela më poshtë paraqet kategoritë e zërave që do të financohen nga kredia që do të jepet, shpërndarja e sasisë së kredisë për çdo kategori dhe përqindja e shpenzimeve për çdo artikull që do të financohet në çdo kategori jepet më poshtë:

	Kategoria	Shpërndarja e kredisë (shprehur në SDR)	% e shpenzimit që do të financohet
1	Punime civile	7,080,000	80 %
2.	Mallra	380,000	100% e shpenzimeve të huaja 100% e shpenzimeve lokale (ex-kost faktor dhe 85 % e shpenzimeve për zërat e tjerë që prokurohen në vend)
3	Shërbime konsulence		85 %
	a) shërbime teknike	130,000	
	b) Shërbime konsulence të tjera; nuk përfshihen shërbimet teknike	880,000	
4	Trajnimi	70,000	100%
5	Kosto operative	940,000	70 %
6.	Kthimi i fondit paradhënie të përgatitjes së projektit	220,000	Shuma paguhet në përputhje me seksionin 2.02 (c) të kësaj Marrëveshjeje
7	Të papërcaktuara	500,000	
Totali		10,200,000	

2. Për qëllime të këtij kapitulli:

a) termi “shpenzime të huaja” do të thotë shpenzime në monedhën e një vendi të ndryshëm nga vendi i Huamarrësit për mallra ose për kryerjen e shërbimeve të një vendi të ndryshëm nga ai i Huamarrësit;

b) termi “shpenzime lokale” do të thotë shpenzime në monedhën e vendit huamarrës për mallra ose për kryerjen e shërbimeve në territorin e vendit huamarrës;

c) termi “shërbime teknike” do të thotë shpenzimet që do të bëhen për hartat, mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e cilësisë së ujit;

d) termi “shtesë mbi koston operative” do të thotë kosto për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen, e cila nuk do të ishte në mungesë të projektit dhe përfshin, midis të tjerave, koston për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinat, pagat e stafit të PMU-së, punonjës të tjerë të marrë në shërbim të PMU-së, pajisjet e zyrave dhe transporti, furnizimin i zyrave të PMU-së, shpenzimet e udhëtimit, hotelit, dietat për stafin e PMU-së gjatë shërbimeve në fushë, njoftimet për prokurimet, seminarët e organizuara nga PMU-ja dhe ndonjë shërbim tjetër për të cilin është rënë dakord nga Shoqata; dhe

e) termi “trajnim” do të thotë shpenzimet e bëra nga PMU-ja në lidhje me aktivitetin e trajnimit gjatë projektit përfshi koston e transportit dhe dietat për të trajnuarit dhe trajnerët duke përjashtuar stafin e PMU-së, ture studimore (dhe seminare) marrja me qira e mjeteve dhe materialeve të trajnimit me pajisjet përkatëse.

3. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 1 më sipër, nuk do të bëhet asnjë tërheqje parash për shpenzimet para se të firmoset kjo Marrëveshje.

4. Shoqata mund të kërkojë të tërheqë nga kredia mbi bazën e shpenzimeve të bëra sipas kontratës për: (a) mallra me kosto më të vogël se 100 000 US\$ për kontratë me përjashtim të dy kontratave të para të prokuruar për blerje ndërkombëtare dhe blerje kombëtare respektivisht; b) punime me kosto më të vogël se 400 000 US\$ për kontratë, me përjashtim të dy kontratave të para

të prokuruar për tendera vendase dhe për punime të vogla respektivisht; c) për shërbimet e konsulentëve individualë që kanë një kosto nën 50 000 US\$ për kontratë; d) për shërbimet e firmave konsulente sipas kontratës që kanë një kosto më të vogël se 100 000 US\$ për kontratë, me përjashtim të kontratës së parë në kategorinë (3) (a) të këtij aneksi; e) kosto e shpenzimeve operative; dhe (f) trajnimet, të gjitha nën këtë term sipas kushteve që Shoqata do të specifikojë sipas njoftimeve të Huamarrësit.

KAPITULLI II PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objekti i projektit është rritja e kontributit të burimeve ujore për të siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme nëpërmjet rritjes së prodhimit bujqësor.

Projekti konsiston në përbërësit e mëposhtëm, të cilët janë objekt i modifikimeve sipas të cilave Huamarrësi dhe Shoqata do të bien dakord kohë pas kohe të arrijnë këto objektiva:

Pjesa A: Rehabilitimi i sistemit

1. Marrja përsipër e skemave për, midis të tjerave: a) rehabilitimin dhe përmirësimin e strukturave ujitëse; b) rehabilitimin dhe përmirësimin e kontrollit nga vërshimet dhe i strukturave kulluese; c) rehabilitimin e rezervuarëve ujitës dhe veprave të marrjes.

2. Realizimi i vrojtimeve në fushën e projekteve të skemave dhe supervizioni i punimeve civile sipas pjesës A.1 të projektit.

3. Zbatimi i EMP-së nëpërmjet: a) parashikimit për trajnimin e fermerëve në lidhje me teknologjitë bujqësore dhe me mirëmbajtjen e sistemit ujitës e kullues brenda fermës, me qëllim që të zbusim rrezikun për ndotjen e mjedisit që rezulton nga rritja e përdorimit të agrokimikateve që shoqërojnë bujqësinë e intensifikuar; dhe b) monitorimin periodik të mjedisit në skemat e pjesës A.1 të projektit.

4. Përcaktimi dhe zgjedhja e skemave në përputhje me planin për zbatimin e projektit (PZP).

Pjesa B. Mbështetja institucionale

1. Sektori i ujitjes, kullimit dhe menaxhimit të vërshimeve

Parashikimi për trajnimet dhe shërbimet e konsultëve midis të tjerave do të jenë: a) zgjerimi dhe forcimi i SHPU-së, FSHPU-së dhe UKSHPU-së; b) postristrukturimi dhe mbështetja teknike për bordet e kullimit; c) fuqizimi i kapacitetit të departamentit të ujërave në MBU.

2. Menaxhimi i burimeve ujore

a) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin e burimeve ujore nëpërmjet: i) krijimit të frymës së konsensusit midis përfituesve sipas një kuadri institucional të përshtatshëm; dhe ii) asistencë teknike për të amenduar ligjet e nevojshme në përputhje me politikën institucionale në të ardhmen.

b) Vlerësimi i zonave që vuajnë nga vërshimet nëpërmjet një vrojtimi në shkallë vendi dhe hartimi i opsioneve alternative për mënyrat e trajtimit.

c) Vlerësimi i kushteve të sigurisë të digave ekzistuese dhe kostoja për mbulimin e tyre ose për mbylljen e tyre në vartësi të gjendjes së tyre, dhe parashikimi i trajnimeve në lidhje me aspektin ligjor dhe teknik të inspektimeve për sigurimë e digave.

d) Krijimi i këshillave të baseneve të lumenjve (KBL) dhe fuqizimi i kapaciteteve të tyre.

e) Rishikimi i stacioneve ekzistuese hidrometrike në zonat e KBL-së së zgjedhur me qëllim që të përcaktojë gjendjen ekzistuese dhe kërkesën e mundshme në të ardhmen për ujin sipërfaqësor, përmirësimin e teknikës së mbledhjes së të dhënave për ujin sipërfaqësor në këto stacione hidrometrike dhe rehabilitimin e stacioneve monitoruese.

f) Fuqizimi i kapacitetit të sekretariatit teknik të Komitetit Kombëtar të Ujërave ose organizmave pasardhës të tij.

Pjesa C: Menaxhimi i projektit

Përmirësimi i kapacitetit institucional të PMU-së në fushat si: menaxhimi financiar dhe informativ, prokurimi, monitorimi dhe vlerësimi.

Projekti pritet të përfundojë më 31 dhjetor të vitit 2008.

KAPITULLI 3 PROKURIMET

Seksioni I. Prokurimi i mallrave dhe punimeve

Pjesa A: Të përgjithshme

Mallrat dhe punimet do të prokurohen në përputhje me parashikimin në seksionin I të “Udhëzimeve për prokurimet me fondet e IBRD-së dhe kredisë së IDA-s” publikuar nga Banka Botërore në janar të vitit 1995 dhe të rishikuar në janar dhe në gusht të vitit 1996, shtator të 1997 dhe janar 1999, si dhe të parashikimeve të mëposhtme të seksionit I të këtij aneksi.

Pjesa B: Tenderat ndërkombëtarë pavarësisht nga çfarë përcaktohet në pjesën C të këtij seksioni, mallrat dhe punimet do të prokurohen sipas çmimit të përcaktuar në kontratë në përputhje me parashikimet e seksionit të II të udhëzuesit dhe paragrafit 5 të shtojcës 1.

Pjesa C: Procedura të tjera prokurimi

1. Tenderat kombëtarë

a) Të përgjithshme

Punimet të cilat vlerësohen me një kosto më të vogël se 400 000 US\$ për kontratë mund të prokurohen dhe kontrata do të fitohet në përputhje me parashikimet e paragrafit 3.3 dhe 3.4 të udhëzuesit.

b) Përmirësimi i procedurave të tenderimit

Me qëllim që të sigurojmë ekonomi, efikasitet, transparencë dhe konsistencë të gjerë me parashikimet e seksionit I të udhëzuesit duhet:

i) ftesa për pjesëmarrje do të bëhet në gazetatat lokale dhe në të paktën dy gazeta kombëtare me tirazh të gjerë, të paktën 30 ditë përpara afatit të dorëzimit të dokumenteve për tender;

ii) konkurruesit e huaj nuk do të përjashtohen nga tenderi dhe nuk do të ketë asnjë lloj preference në krahasim me konkurruesit vendas gjatë procesit të konkurrimit. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen të konkurrojnë vetëm në rast se ato janë legalisht dhe financiarisht autonome dhe funksionojnë sipas ligjit tregtar të Huamarrësit;

iii) konkurrimi nuk do të jetë i ndaluar për firmat e pararegjistruara;

iv) entet prokuresse do të përdorin dokumentet e tenderit të miratuara nga Shoqata para se ato t’u jepen pjesëmarrësve në konkurrim;

v) ofertat duhet të hapen në publik në një vend të caktuar, menjëherë pas afatit të fundit të dorëzimit të ofertave, në prezencë të përfaqësuesve të konkurrentëve;

vi) në rast të paraqitjes së çmimit të lartë të ofertës e krahasuar me vlerësimin zyrtar, të gjitha ofertat mund të refuzohen me miratimin paraprak të Shoqatës;

vii) në rast të paraqitjes të më pak se tre ofertave të rregullta, të gjitha ofertat mund të refuzohen dhe mund të thirren oferta të reja pa marrë miratimin paraprak të Shoqatës;

viii) për dorëzimin e ofertave do të përdoret procedura e një zarfi të vetëm;

ix) paskualifikimi do të bëhet vetëm për ofertuesin e ofertës më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet në momentin e hapjes së tenderit për arsye që kanë të bëjnë me kualifikimin;

x) ofertuesit të cilët kontraktojnë si *joint-venture* do të jenë përgjegjës bashkë dhe secili më vete;

xi) ofertuesve mund t’u kërkohet të paraqesin sigurimin e ofertës në një sasi që të jetë e përshtatshme me vlerën inxhinerike të kontratës, si dhe të jetë në një formë të pranueshme nga Huamarrësi;

xii) përpara se të refuzohen të gjitha ofertat dhe të thirren oferta të reja duhet marrë miratimi i Shoqatës;

xiii) kontratat duhet të lidhen me ofertuesin e ofertës së rregullt më të ulët, i cili kualifikohet të kryejë punimet në përputhje me kriteret e paracaktuara dhe të bëra të njohura më parë;

xiv) nuk lejohen negociatat pas tenderit me ofertuesin e ofertës më të ulët dhe as me ndonjë ofertues tjetër; dhe

xv) kontratat afatgjata (më shumë se 18 muaj) duhet të përmbajnë dispozitat e duhura për rregullimin e çmimeve.

2. Blerjet ndërkombëtare

Mallrat të vlerësuara me kosto më të vogël se 100 000 US\$ ekuivalente për kontratë, mund të prokurohen bazuar në procedurën e blerjeve ndërkombëtare në përputhje me paragrafët 3.5 dhe 3.6 të udhëzuesve.

3. Blerjet kombëtare

Mallrat e vlerësuara me një kosto më të vogël se 500 000 US\$, ekuivalente për kontratë, mund të prokurohen bazuar në procedurat e blerjeve kombëtare në përputhje me paragrafët 3.5 dhe 3.6 të udhëzuesve.

4. Prokurimet e punimeve të vogla

Punimet e vlerësuara me një kosto më të vogël se 50 000 US\$ ekuivalente për kontratë, mund të prokurohen në procedurën e *Lump-sum* ose atë të kontratës me çmim fiks duke u bazuar në kuotimet e marra nga tre (3) kontraktorë të kualifikuar të vendit në përgjigje të ftesës së bërë me shkrim. Ftesa duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të punimeve përfshirë specifikimet bazë, datën e caktuar të përfundimit, një formular bazë të Marrëveshjes e pranueshme kjo për Shoqatën, si dhe vizatimet e duhura atje ku është e aplikueshme. Kontrata do të lidhet me kontraktorin që ofron çmimin më të ulët për punën që kërkohet dhe që ka eksperiencën dhe burimet e duhura për të përfunduar kontratën me sukses.

Pjesa D: Shqyrtimi nga Shoqata i vendimeve të prokurimeve

1. Plani i prokurimit

Përpara daljes së ftesës për tender për kontratat, Shoqatës duhet t'i paraqitet plani i projektit i propozuar për prokurimet, për shqyrtim nga ana e saj, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të shtojcës 1 të udhëzuesit. Prokurimet e të gjitha mallrave dhe punimeve duhet të kryhen në përputhje me planin e prokurimit të aprovuar nga Shoqata dhe në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të përmendur më lart.

2. Rishikimi paraprak

a) Përsa i përket kontratave të prokuruar sipas pjesës B, si dhe dy kontratave të para sipas pjesës C.1 të këtij kapitulli, do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafët 2 dhe 3 të shtojcës 1 të udhëzuesve.

b) Përsa i përket dy kontratave të para të prokuruar sipas pjesëve C.2,3 dhe 4 të këtij kapitulli do të zbatohen procedurat e mëposhtme:

i) përpara zgjedhjes së furnitor/zbatuesit të kontratës së prokuruar sipas procedurave të blerjes, Huamarrësi do të paraqesë te Shoqata raportin mbi krahasimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura;

ii) përpara zbatimit të kontratave të prokuruar sipas procedurave të blerjes, Huamarrësi do të paraqesë te Shoqata një kopje të specifikimeve dhe të kontratës draft;

iii) do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafin 2(f), 2(g) dhe 3 në shtojcën 1 të udhëzuesit.

3. Rishikimi i mëvonshëm

Për kontratat që nuk udhëhiqen nga paragrafi 2 i kësaj pjese, do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafin 4 të shtojcës 1 të udhëzuesve.

Seksioni II. Punësimi i konsulentëve

Pjesa A: Të përgjithshme

Shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në përputhje me dispozitat e seksionit I dhe IV të udhëzuesve. Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore publikuar nga Banka në janar 1997 dhe rishikuar në shtator 1997, janar 1999 dhe maj 2002 (udhëzuesi për konsulentët), paragrafi 1 i shtojcës 1, shtojca 2 dhe dispozitat e mëposhtme të seksionit II të këtij kapitulli.

Pjesa B: Metoda e përzgjedhjes bazuar në cilësinë dhe koston

1. Përveç asaj që është paraqitur në pjesën C të këtij seksioni, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave në përputhje me dispozitat e seksionit II të udhëzuesve për konsulentët dhe dispozitat të paragrafëve 3.13 deri në 3.18 të saj të aplikuara për metodën e përzgjedhjes së konsulentëve bazuar në cilësinë dhe koston.

2. Dispozita e mëposhtme do të zbatohet për prokurimin e shërbimeve të konsulencës në përputhje me ato të paragrafit paraprirës; lista e shkurtër (*short list*) e konsulentëve për shërbimet e vlerësuara më pak se 100 000 US\$ ekuivalente për kontratë, mund të përmbajë të gjithë konsulentët vendas në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.7 dhe shënimit 8, në fund të faqes, të udhëzuesit për konsulentët.

Pjesa C: Metoda të tjera për përzgjedhjen e konsulentëve

1. Metoda e përzgjedhjes së kostos më të vogël

Shërbimet për audimin mund të prokurohen në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.1. dhe 3.6 të udhëzuesit për konsulentët.

2. Metoda e përzgjedhjes bazuar në kualifikimin e konsulentëve

Shërbimet për asistencën teknike, përgatitja dhe rishikimi i projektit, këshilla ligjore dhe institucionale, udhëtime pune, kontrolli i cilësisë, të vlerësuara me një kosto më të vogël se 100 000 US\$ ekuivalente për kontratë mund të prokurohen në përputhje me dispozitat e paragrafëve 3.1 dhe 3.7 të udhëzuesve për konsulentët.

3. Metoda e përzgjedhjes së konsulentëve individualë

Shërbimet e asistencës individuale për detyrat të cilat në përputhje me kërkesat e paraqitura në paragrafin 5.1 të udhëzuesve për konsulentët, do të prokurohen në përputhje me dispozitat e paragrafëve 5.1 deri në 5.3 të udhëzuesve të konsulentëve.

Pjesa D: Rishikimi nga Shoqata i përzgjedhjes së konsulentëve

1. Plani i përzgjedhjes

Plani për përzgjedhjen e konsulentëve, i cili do të përfshijë vlerësimet e kostos së kontratës, paketën e kontratës, kriteret dhe procedurat e përdorura për përzgjedhjen, do t'i paraqitet Shoqatës për shqyrtim dhe aprovim përpara daljes të konsulentët të kërkesave për propozim. Ky plan duhet të rifreskohet çdo 6 muaj gjatë zbatimit të projektit, dhe çdo rifreskim i tillë duhet t'i jepet Shoqatës për shqyrtimin dhe aprovimin e tij. Përzgjedhja e të gjitha shërbimeve për konsulentët do të kryhet në përputhje me planin e përzgjedhjes (i rifreskuar herë pas here) siç është aprovuar nga Shoqata.

2. Rishikimi paraprak

a) Përsa i përket: i) çdo kontrate për punësimin e firmave konsulente me kosto të vlerësuara 100 000 US\$ ose më shumë; dhe ii) kontratës më përpara për shërbimet teknike, do të përdoren procedurat e paraqitura në paragrafin 2, 3 dhe 5 të shtojcës 1 të udhëzuesve për konsulentët.

b) Përsa i përket kontratave për punësimin e konsulentëve individualë me një kosto të vlerësuar në 50 000 US\$ ose më shumë, raporti i krahasimit të kualifikimit dhe eksperiencës së kandidatëve termat e referencës, si dhe termat për punësimin e konsulentëve do t'i paraqiten Shoqatës për rishikim dhe aprovim paraprak. Kontrata do të lidhet vetëm pas marrjes së aprovimit. Për kontrata të tilla do të zbatohen dispozitat e paragrafit 3 të shtojcës 1 të udhëzuesit për konsulentët.

3. Rishikimi i mëvonshëm

Për kontratat që nuk udhëhiqen nga paragrafi 2 i kësaj pjese, do të zbatohen procedurat e paraqitura në paragrafin 4 të shtojcës 1 të udhëzuesve të konsulencës.

KAPITULLI 4 PROGRAMI I ZBATIMIT

1. Huamarrësi:

a) do të ndjekë politika dhe procedura të përshtatshme në mënyrë të tillë që të arrijë të monitorojë dhe vlerësojë mbi parime bazë zbatimin e projektit dhe arritjen e objektivave, në përputhje me treguesit e kënaqshëm për Shoqatën;

b) do të përgatisë, sipas termave të referencës të kënaqshme për Shoqatën në ose rreth datës 31 tetori 2006, një raport i cili përfshin rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të kryera në vijim të paragrafit (a) të këtij seksioni, mbi përparimin e arritur në zbatim të projektit gjatë periudhës që shtrihet përpara datës së këtij raporti, duke prezantuar masat rekomanduese për të siguruar efikasitetin e zbatimit të projektit dhe arritjes së objektivave gjatë periudhës në vijim të datës së sipërpërmendur; dhe

c) do të rishikojë me Shoqatën nga 31 dhjetori 2006 ose një datë të mëvonshme, siç do të kërkohej nga Shoqata, raportin e përmendur në paragrafin (b) të këtij seksioni dhe më pas do të marrë të gjitha masat e kërkuara për të siguruar përfundimin me efikasitet të projektit, si dhe të arrijës së objektivave, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e këtij raporti, si dhe të pikëpamjeve të shoqatës mbi çështjen.

2. Për zbatimin e pjesës A.1 të projektit, Huamarrësi do të përzgjedhë nënshemat në mënyrën e mëposhtme:

a) për pjesën A.1(a) dhe (b) të projektit, do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës një vlerësim të mjedisit për çdo nënshemë në një skemë të re në përputhje me PIP për shqyrtim dhe miratim nga Shoqata; dhe

b) për pjesën A.1 (c) të projektit do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës një plan ku përcaktohet përshkrimi, buxheti dhe koha çdo nënshemë në një skemë të re në përputhje me PIP-in për shqyrtim dhe miratim nga Shoqata.

3. Për pjesën A (a) të projektit, Huamarrësi:

a) do të bëjë një marrëveshje transferimi ndërmjet Huamarrësit dhe çdo përfituesi sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në PIP dhe të miratuara nga Shoqata; dhe

b) do të ushtrojë të drejtat që burojnë nga Marrëveshja në një mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Shoqatës dhe të përmbushë qëllimet e projektit dhe nuk do të caktojë, ndryshojë, abrogojë ose marrë parasysh marrëveshje të tilla ose dispozita pa miratimin paraprak të Shoqatës.

4. Huamarrësi:

a) do të koordinojë dhe monitorojë zbatimin e përgjithshëm të pjesës A.1 të projektit dhe do të mbikëqyrë kryerjen nga përfituesi të detyrimeve të tyre sipas marrëveshjeve përkatëse në përputhje me PIP;

b) do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës për shqyrtim dhe komente buxhetin për Departamentin e Menaxhimit të Ujit në MBU për çdo vit kalendarik; dhe

c) jo më vonë se 30 qershori i çdo viti, do të zhvillojë një auditim vjetor për shpenzimet për çdo bord kullimi.

5. Huamarrësi, deri më 31 mars 2005, do të krijojë 5 borde të tjera kullimi në përputhje me ligjin e ujitjes dhe kullimit.

6. Huamarrësi deri më 31 mars 2005, do të përfundojë transferimin e përgjegjësisë menaxheriale për ujitjen nga bordet e kullimit të SHPU-së.

7. Huamarrësi do të zbatojë planin e tranzicionit në një mënyrë të pranueshme për Shoqatën dhe zbatimi do të monitorohet çdo gjashtëmuor në përputhje me udhëzimet e Shoqatës. Në lidhje me zbatimin e planit të tranzicionit, Huamarrësi do të sigurojë se çdo caktim dhe/ose pushim i ri i personelit në pozicione të rëndësishme në Departamentin e Menaxhimit të Ujit në MBU-së është përcaktuar në bazë të kapacitetit dhe kualifikimit të personelit në përputhje me ligjet në vijim të Huamarrësit.

KAPITULLI 5 LLOGARIA SPECIALE

1. Për qëllime të këtij kapitulli:

a) termi “kategori të përshtatshme” nënkupton kategoritë (1) deri në (5) të përcaktuara në tabelën e paragrafit 1 të kapitullit 1 të kësaj Marrëveshjeje;

b) termi “shpenzime të përshtatshme” nënkupton shpenzimet në lidhje me kosto të arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve që kërkohej për Projektin dhe që do të financohen nga kredia e alokuar në kategori të përshtatshme në përputhje me paragrafët e kapitullit 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

c) termi “alokim i autorizuar” nënkupton një shumë të barasvlefshme me 1 000 000 US\$ që do të tërhiqet nga llogaria e kredisë dhe do të depozitohet në llogarinë speciale sipas paragrafit 3 (a) të këtij kapitulli, me kusht që, nëse Shoqata nuk do të bjerë dakord ndryshe, alokimi i autorizuar do të kufizohet në një shumë të barasvlefshme me 500 000 US\$ derisa shuma agregate e tërheqjeve nga llogaria e kredisë plus shumën totale të të gjitha pagesave speciale të papaguara të regjistruara nga

Shoqata në vijim të seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme do të barazohet ose tejkalohet shumë ekuivalente me 2 000 000 SDR.

2. Pagesat nga llogaria speciale do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të përshtatshme në përputhje me udhëzimet e këtij kapitulli.

3. Pasi Shoqata të ketë marrë evidenca të kënaqshme për të se llogaria speciale është hapur siç duhet, tërheqjet e alokimit të autorizuar dhe tërheqjet në vazhdim për të mbushur llogarinë speciale do të bëhen si më poshtë:

a) Për tërheqje nga alokimi i autorizuar, Huamarrësi do t'i dërgojë Shoqatës një kërkesë ose kërkesa për një depozitim në llogarinë speciale të një shume ose shumave që nuk e tejkalojnë shumë agregate të alokimit të autorizuar. Në bazë të kësaj kërkesë ose kërkesave, Shoqata, në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale këtë shumë ose shumë që ka kërkuar Huamarrësi.

b) (i) Për mbushjen e llogarisë speciale, Huamarrësi do t'i dërgojë Shoqatës kërkesa për depozitime në llogarinë speciale në periudha kohe të specifikuar nga Shoqata.

ii) Para ose në kohën e çdo kërkesë, Huamarrësi do t'i dërgojë Shoqatës dokumente dhe evidenca të tjera që kërkojnë sipas paragrafit 4 të këtij kapitulli për pagesën ose pagesat, për të cilat është kërkuar mbushja. Në bazë të kësaj kërkesë, Shoqata, në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga llogaria e kredisë dhe do të depozitojë në llogarinë speciale këtë shumë që ka kërkuar Huamarrësi dhe që, siç paraqitet nga dokumentet dhe evidenca të tjera, është paguar nga llogaria speciale për shpenzime të përshtatshme. Të gjitha depozitimet do të tërhiqen nga Shoqata nga llogaria e kredisë sipas kategorive të përshtatshme përkatëse dhe në shumat përkatëse të barasvlefshme që justifikohen nga dokumentet dhe evidenca të tjera.

4. Për çdo pagesë që bën Huamarrësi nga llogaria speciale, Huamarrësi, kur të kërkojë nga Shoqata, do t'i dërgojë Shoqatës dokumente dhe evidenca të tjera që vërtetojnë se kjo pagesë është bërë për shpenzime të përshtatshme.

5. Pavarësisht nga udhëzimet e paragrafit 3 të këtij kapitulli, Shoqatës nuk do t'i kërkojë të bëjë depozitime të mëtejshme në llogarinë speciale.

a) nëse Shoqata vendos që të gjitha tërheqjet e mëtejshme duhen bërë nga Huamarrësi direkt nga llogaria e kredisë në përputhje me paragrafët e nenit 5 të kushteve të përgjithshme dhe paragrafit (a) të seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

b) nëse Huamarrësi dështon t'i dorëzojë Shoqatës, brenda kohës së specifikuar në seksionin 4.01 b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë raport kontrolli që kërkojë nga Shoqata sipas seksionit të mësipërm në lidhje me kontrollin e regjistrimeve dhe llogarive për llogarinë speciale;

c) nëse Shoqata njofton Huamarrësin për pezullim të plotë ose të pjesshëm të së drejtës së Huamarrësit për të tërhequr nga llogaria e kredisë sipas udhëzimeve të paragrafit 6.02 të kushteve të përgjithshme; ose

d) menjëherë sapo shuma totale e patërhequr e kredisë së alokuar në kategori të përshtatshme minus shumë totale të të gjitha pagesave speciale të papaguara të regjistruara nga Shoqata sipas seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme do të barazohet me dyfishin e shumës së alokimit të autorizuar.

Më pas, tërheqjet nga llogaria e kredisë të shumës së kredisë së alokuar në kategori të përshtatshme e mbetur e patërhequr do të kryhen sipas procedurave që Shoqata do t'i njoftojë Huamarrësit. Këto tërheqje do të bëhen vetëm pasi dhe deri kur Shoqata të jetë e bindur se të gjitha shumat e mbetura në depozitë në llogarinë speciale që nga data e njoftimit do të përdoren për pagesa për shpenzime të përshtatshme.

6 a) Nëse Shoqata vendos se çdo pagesë nga llogaria speciale: (i) është bërë për një shpenzim ose në një shumë jo të përshtatshme sipas paragrafit 2 të këtij kapitulli; ose (ii) nuk është justifikuar me dokumente evidentuese, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Shoqata: (a) do të sigurojë dokumente shtesë siç mund të kërkojnë nga Shoqata; ose (B) do të depozitojë në llogarinë speciale (ose, nëse Shoqata do ta kërkojë, do t'i kthejë Shoqatës) një shumë të barabartë me shumë e pagesës ose të pjesës që nuk është e përshtatshme apo e justifikuar. Nëse Shoqata nuk bie dakord ndryshe, Shoqata nuk do të bëjë asnjë depozitim të mëtejshëm në llogarinë speciale deri sa Huamarrësi të ketë dorëzuar dokumente evidentuese ose të ketë depozituar ose kthyer këtë shumë,

sipas rastit.

b) Nëse Shoqata vendos se çdo shumë e papërdorur në llogarinë speciale nuk do të kërkohet për pagesa të tjera për shpenzime të përshtatshme, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Shoqata, do t'i kthejë Shoqatës këtë shumë të papërdorur.

c) Huamarrësi, pas njoftimit nga Shoqata, mund t'i kthejë Shoqatës të gjitha ose një pjesë të fondeve të depozituara në llogarinë speciale.

d) Kthimet e shumave që bëhen sipas paragrafëve 6 (a), (b) dhe (c) të këtij kapitulli do t'i shtohen llogarisë së kredisë për tërheqje të mëvonshme ose për anulim në përputhje me udhëzimet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë kushtet e përgjithshme.

Tabela e vendimit nr.786, datë 26.11.2004 botuar në Fletoren Zyrtare nr.87

Tabela nr.1

Tabela e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit	Pikët e vlerësimit Totali 100 pikë
1. Planbiznesin për zhvillimin e veprimtarisë në kazinotë ku aplikohet	10
2. Planzhvillimin nga pikëpamja turistike e zonës ku do të ushtrohet kjo veprimtari	40
3. Përvoja e subjektit në fushën e kazinove apo të lojërave të fatit	30
4. Madhësia e kapitalit në lekë	
30 000 000-1 000 000 000	8
Mbi 1 000 000 000	12

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 17.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë